

LEXMARK
LEGAL

PO MENDONI TË EMIGRONI NË MB DHE JU
DUHEN KËSHILLA TË SIGURTA LIGJORE?

JENI NË VENDIN E DUHUR!

Ekipi ynë i avokatëve të specializuar në emigracion ofron
asistencë profesionale për:

- Aplikime për viza
- Çështje azili
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Apeli kundër dëbimit
- Shtetësi britanike

Ne ju mbështesim me përkushtim dhe
transparencë në çdo fazë të procesit.

E ARDHMJA JUAJ NË MB FILLON ME
VENDIMIN E DUHUR.

Kontaktoni Lexmark Legal sot – ekspertët
që ju qëndrojnë pranë në çdo hap.
Partneri juaj i besueshëm në emigracion.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488

Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

www.lexmarklegal.com

The Albanian

VITI I 23 I BOTIMIT 25 SHKURT 2026

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

CILI ËSHTË SISTEMI I RI I UDHËTIMIT NË MBRETËRINË E BASHKUAR DHE SI PREKEN PERSONAT ME SHTETËSI TË DYFISHTË?



PETRIT KUÇANA

KUSH I 'NGRIU' FLATRAT E VERIUT?



ARBEN MANAJ

SKANDALI EPSTEIN TRONDIT BRITANINË, NËN HETIM FLUTURIMET E "LOLITA EXPRESS"


TË DYMBËDHJETËT E PAMJAFTUESHËM!

AUREL PLASARI



DROJA E TYRE PREJ LAVDISË SË ADEM DEMAÇIT

REXHEP QOSJA



LIRIA KISHTE EMËR?

VISAR ZHITI



THYERJA E BESIMIT

DITMIR BUSHATI



KATËR MËSIMET PREJ KATËR VJETËVE TË AGRESIONI RUS

VETON SURROI



Rashid A.Khan Solicitor (Principal) Mob: 07774222062 190 MERTON HIGH STREET WIMBLEDON, LONDON SW19 1AX



RASHID & RASHID

Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Kush do ta besonte që 5 vite pas 18 prillit 2021, kur Edi Rama u ul e Aeroportin e Kukësit bashkë me udhëtarët e ardhur nga Londra, gjithçka do të ngjajë si një pamundësi, qoftë edhe për tu turpëruar.

Kaq shumë zell, kaq shumë impenjim kishte ato ditë, sa që shumëkush besoi se vërtet qarku më i varfër i vendit, kishte ardhur në një pikë kthese dhe se turizmi, jo vetëm nga

Londra, do të ishte shpëtimtar për mjerimin e paskajshëm të qarkut.

Gati-gati nostalgjike në kufinj të së pabesueshmes duken ato pamje, ku duket se nuk kishin fund karriget e mbushura me njerëz të administratës, dhe fjalimi i famshëm i kryeministrit se e përmbushi premtimin e tij për të çuar në aeroport çunat e Londrës (mbase ky term u përdor për herë të parë nga kryeministri) e paskërkan sharë kryeministrin me libër shtëpie.

Ngjason me një tragji-komedi ku aktori i vetëm vjen në skemë, me gjithë pathosin e tij, me 'fuqinë e Mujit' i pret lakun e varfërisë qarkut më të varfër të republikës.

Duartrokitje të pafundme.



Lavdi shpëtimtarit!

Lavdi kryeministrit që po e bën Shqipërinë, që u kujtua edhe për këtë qark verior më i varfër i republikës...

Asnjë fjalë nuk u tha për pronarët, menaxhesit e këtij aeroporti pasi do

të binte edhe fabula e shpëtimtarit... por pas kaq vitesh ka vetëm një pyetje; Kush i ngriu "Flatrat e Veriut"? (kështu quhet aeroporti i Kukësit).

Mjafton një kerkim i thjeshtë në internet për të shikuar se numri i fluturimeve në Aeroport është zero. Zhbëhet pël-hura e turpshme që u end ato ditë në prag-fushatën elektorale dhe Flatrat e veriut mbeten të ngrira.

Asnjë fluturim i vetëm, asnjë ardhje, asnjë shkuarje duke e lënë aeroportin jo vetëm pa 'çunat e Londrës'

por pas asnjë lloj çuni apo çupe, në bumin e madh të turizmit që ushton në çdo media.

Do të ishte më e natyrshme pyetje se çfarë ndodhi me Aeroportin e Kukësit?

Do të ishte detyrim i kryeministrit të përgjigjej dhe ai qark do të dilte nga agonia e mjerimit, kryeministri që vendosi takesën në rrugën e kombit, u hoqi edhe këtë shans banorëve të qarkut të Kukësit, që aeroportin e kanë të mbyllur, si për të ruajtur të pandryshueshmë mjerimin, bashkë me tragjikomedinë se na ishte njëherë kryeministri që preu një shirit, por aeroporti vazhdon të jetë i mbyllur. (Vetëm për pak kohë ka operuar me ndonjë linjë të papërfillshme). Kushedi sa herë do të kujtohet thënia e Kurtit se dëshiron të vijë në Shqipërinë e Kastriotit dhe jo të Kastratit...

ribotim

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



The Albanian

L E X M A R K
L E G A L

DËSHIRONI TË JETONI, PUNONI APO STUDIONI NË MB?

Ne ofrojmë shërbime të specializuara imigrimi, të përshtatura sipas rrethanave tuaja.

Ekipi ynë profesionist ju udhëzon në çdo hap, duke e bërë procesin e imigrimit të qartë, të sigurt dhe pa stres.

SHËRBIMET TONA PËRFSHIJNË:

- Viza për punëtorë të kualifikuar
- Viza studimi
- Viza për bashkëshort dhe familjarë
- Viza Global Talent & Inovative
- Punonjës fetarë
- Vendbanim të përhershëm (ILR)
- Shtetësi britanike
- Apeline dhe rishikime vizash

Ne ju ndihmojmë me këshillim profesional, përgatitje dokumentesh dhe mbështetje të plotë gjatë aplikimit.

Na kontaktoni sot për një të ardhme më të sigurt në Mbretërinë e Bashkuar.

Ekspertë të besuar të imigracionit.



- 07494181220
- 07435119343
- 02080902488



Ashley House 235 - 239
High Road, Wood Green,
London N22 8HF

ARBEN MANAJ

Shtatë forca policore po hetojnë seriozisht dosjet e skandalit Epstein si dhe 90 fluturime të "Lolita Express" drejt Britanisë dhe nga Britania, ndërkohë që vëllai i Mbretit, ish-princi Andreës, të cilit i është hequr titulli mbretëror, po hetohet për trafikim seksual. Hetimet janë përqëndruar në terminalin e avjonëve privat në aeroportin e Stanstead-it, rreth 50 km në verilindje të Londrës, ku mbrinin dhe niseshin avjonët në pronësi të ish-financierit pedofil amerikan Jeffrey Epstein.

Mësohet se 15 nga këto fluturime kanë ndodhur, madje edhe pasi ish-financieri amerikan ishte i burgosur në vitin 2008 për lehtësimin e seksit me vajza të mitura.

Polica e Essexit, po kalon në sitë gjithë dokeumentacionin e fluturimeve dhe email-at në këtë terminal. Ish-kryeministri laburist Gordon Brown thotë se mesazhet e lidhin ish-princin Andreë, 65 vjec, me të paktën një viktimitë e sjell me avjon në linjën "Lolita Express" e më pas, të futur fshehurazi brënda në Pallatin Mbretëror, Buckingham Palace.

Fituesit surprizë ishin të Gjelbrit, të udhëhequr nga lideri i ri karizmatik Zack Polanski

Kryeministri britanik, Keir Starmer, po përballlet me presion të madh pasi Partia Laburiste pësoi një humbje të thellë në zgjedhjet e pjeshme në zonën Gorton dhe Denton, në periferi të Manchesterit.

Kjo zonë konsiderohej prej dekadash një bastion i sigurt për laburistët. Vetëm një vit e gjysmë më parë, në zgjedhjet e përgjithshme, Laburistët kishin fituar aty me 51% të votave. Por këtë herë, partia shkoi në vendin e tretë me vetëm 26%, duke u tejkalluar nga dy parti populiste.

Fituesit surprizë ishin të Gjelbrit, të udhëhequr nga lideri i ri karizmatik Zack Polanski. Kandidatja e tyre, Hannah Spencer, arriti 41% të votave, duke siguruar fitoren e parë historike të partisë në veri të Anglisë. Në vend të dytë doli partia e djathtë Reform UK, e drejtuar nga Nigel Farage, me 29% të votave.

Pse është kjo humbje kaq e rëndë?

Humbja shihet si një sinjal alarmi për Starmer. Brenda Partisë Laburiste ka pakënaqësi të forta, dhe disa figura tashmë kanë tentuar ta sfidojnë udhëheqjen e tij. Skandali i fundit me ish-ministrin Peter Mandelson, i cili u përfshi në polemika për lidhjet e tij me financierin amerikan Jeffrey Epstein, ka dëmtuar më tej imazhin e qeverisë.

Edhe pse Starmer ka deklaruar se nuk do të dorëhiqet, shumë deputetë

SKANDALI EPSTEIN TRONDIT BRITANINË, NËN HETIM FLUTURIMET E "LOLITA EXPRESS"

7 forcat policore pjesë e Policisë britanike, janë duke hetuar edhe ish-Ambasadoren britanikë në Uashington, Lordin Mendelson, duke kaluar nëpër prova potencialisht komprometuese për kalimin e informacioneve sensitive ish-financierit amerikan Epstein, në kohën kur ka qënë Ministri i Biznesit në kohën e qeverisë së ish-kryeministri Gordon Brown.

Polica ka bërë kontrolle në dy nga banesat e tij, njëra në Londër dhe tjetra në Anglinë qendrore.

Sakaq, një forcë tjetër policore po heton ish-princin për rolin e tij në kohën kur ai ka qënë i dërguari zyrtar britanik për tregëtinë dhe biznesin në vitet 2001-2011.

Prokuroria po heton edhe pretendimet se një femër tjetër në të 20-at, është dërguar nga Epstein në Britani në 2010 për marrëdhënie seksuale me ish-Princin në një nga pronat e Famil-

jes Mbretërore. Pjesë e hetimit është edhe aeroporti i Luton në veri të Londrës.

Ndërkohë që Policia Metropolitanë në Londër është në kontakt me FBI-në, për marrjen e dokumentave të paredaktuara, një grup i specilizuar është krijuar nga Këshilli i Shefave të Policisë britanike, për të koordinuar operacionet dhe ndermjetësimin me zyrtarët amerikane të ligjzbatimit. Ish-Princi Andrew i cili tashmë njihet vetëm me emrin Andrew Mountbatten Windsor, më parë i ka mohuar gjithë pretendimet e ngritura ndaj tij, por nuk ka reaguar drejtëpërdrejt për pretendimet e fundit nga publikimi i 3 milionë dosjeve të Epstein.

Përmendja e emrit nuk nënkupton domosdoshmërisht ndonjë transgresion kriminal.



TRONDITET POLITIKA BRITANIKE/ HUMBJE E MADHE PËR KEIR STARMER NË MANCHESTER, POZITA E TIJ NË RREZIK



laburistë kanë frikë se partia po humbet mbështetjen si nga e majta, ashtu edhe nga e djathta.

Çfarë ndodhi në Gorton dhe Denton?

Zona ka një përbërje të veçantë demografike. Gorton ka një popullsi të madhe emigrantësh, kryesisht mysli-

manë dhe me origjinë aziatike. Atje, të Gjelbrit zhvilluan një fushatë shumë aktive pro Palestinës dhe kundër politikave të ashpra të emigracionit.

Nga ana tjetër, Denton ka më shumë banorë të bardhë britanikë dhe të moshuar. Këtu, Reform UK arriti të fitojë shumë mbështetje me mesazhe kundër emigracionit dhe retorikë na-

cionaliste.

Çfarë pritet tani?

Kjo humbje vjen vetëm dy muaj para zgjedhjeve të rëndësishme lokale në Mbretërinë e Bashkuar dhe atyre kombëtare në Skoci dhe Uells. Rezultatet e ardhshme mund të vendosin fatin politik të Starmer. Megjithëse laburistët ende kanë shumicë të

madhe në Parlament, presioni po rritet. Nëse humbjet vazhdojnë, pozita e kryeministrit mund të bëhet e paqëndrueshme.

Zhvillimet e fundit tregojnë se politika britanike po hyn në një fazë të re pasigurie, ku votuesit po largohen nga partitë tradicionale dhe po kërkojnë alternativa të reja.

AUREL PLASARI

Ja edhe një rast kur historia lexohet për të mësuar: që për të ruajtur lirinë nuk mjaftojnë 12 të panështruar përkundrejt 1.238 të nënshtruarve, edhe profesorë qofshin ata.

E ka ofruar një mësim të tillë historie eseisti Giorgio Boatti me librin 'Preferirei di no. Le storie dei dodici professori che si opposero a Mussolini' (bot. Einaudi 2001).

"Çikë e nga një çikë", kjo ka qenë teknika dinake e regjimit fashist për të privuar qytetarët nga liria. Një masë ligjore tani, një masë ligjore pastaj, hiq pak liri këtu, zhvat pak liri atje.

Synimi: që qytetari të mos e ndiejë se ç'po ndodh me lirinë e tij derisa më në fund ta gjejë veten të zhveshur krejtësisht prej saj. Kështu u vunë në funksionim në Italinë fashiste ato masa që njihen si ligjet "fascistissime".

I pari ndër to, për të siguruar aderimin sa më të rrasët të intelektualëve në regjimin fashist, ishte një ligj i 24 dhjetorit 1925, që kishte për objekt funksionarët shtetërorë, si pjesë e tyre edhe trupën mësimdhënëse. Njëpërmjet tij u largua nga mësimdhënia i pari kontingjent prej 500 vetash, nga rektorë deri mësues shkolle filllore, si "persona të papërshtatshëm" në raport me parimin e formuluar nga vetë Mussolini:

"Në Itali nuk ka vend për antifashistët; ka vend vetëm për fashistët, ndërsa për 'afashistët' vetëm kur të jenë qytetarë të ndershëm dhe shembullorë".

Me ligjin e 28 gushtit 1931 regjimi fashist e shtrëngoi edhe më profesoro-



ratin në darën e privimit të lirisë dhe të nënshtrimit; ai i detyronte profesorët universitarë të betoheshin për besnikëri ndaj fashizmit me këtë formulë:

"Betohem t'i jem besnik Mbretit, trashëguesve të tij mbretërorë, dhe Regjimit Fashist, të respektoj besnikërisht Statutin dhe ligjet e tjera të shtetit, të ushtrij detyrën e mësimdhënies dhe të përbush të gjitha detyrimet akademike me synimin për të formuar qytetarë veprimtarë, të ndershëm e të devotshëm ndaj atdheut dhe Regjimit Fashist. Betohem që nuk bëj pjesë dhe nuk do të bëj pjesë në shoqata ose parti veprimtaria e të cilave nuk përputhet me detyrimet e detyrës sime".

Me fjalë më të thjeshta kjo do të thoshte jo vetëm që profesorët duhej të ishin "fashistë", por atyre u kërkohet të prodhonin nëpër auditorë "fashistë në seri".

TË DYMBËDHJETËT E PAMJAFTUESHËM!

Vetëm 12, ndër 1.250 profesorë gjithsej, nuk iu nënshtruan vullnetit të Duces. Historitë njerëzore të të dymbëdhjetëve ka mbledhur dhe ka rindërtuar në librin e tij Giorgio Boatti: Dikush i pensionuar përdhunshëm para kohe. Dikush tjetër i shtrënguar të nënshkruante dorëheqjen. Të tjerë të përjashtuar nga mësimdhënia në çdo nivel, madje edhe nga mësimdhënia private në shtëpi.

Një tjetër i përndjekur nga kontrollat dhe bastisjet e vijueshme të policisë sekrete fashiste. Tjetri me degdisje në kamp përqendrimi. Ndonjë në burg, ku edhe vdiq. Etj.

Nëse disa ndër të dymbëdhjetët mund të llogariten për antifashistë, për shembull ata syresh që kishin nënshkruar më 1925 "Manifestin e Intelektualëve Antifashistë" të

Benedetto Croce-s, të tjerë e refuzuan një betim të tillë thjesht jo se qenë antifashistë, por sepse ai binte ndesh me ndërgjegjen e tyre profesionale.

Për shembull, siç e shpallte në refuzimin e tij njëri syresh: "Akti im nuk synon të ketë asnjë domethënie politike. Është thjeshtësisht një akt respekti ndaj imperativit kategorik të detyrës".

Kaq sa për të dalluar se ç'është ndërgjegjja profesionale.

Të dymbëdhjetët, për shkak të një refuzimi të tillë, humbën jo vetëm karrierën, por edhe lirinë vetjake, shpesh edhe atë familjare.

Mbase edhe jetën. Por i qëndruan lirisë së mendimit dhe rezultuan me llogari të qëruara me ndërgjegjen e vet. Ruajtën edhe dinjitetin dhe, përkatësisht, emrin e mirë me të cilin ende sot po kujtohen.

Edhe pse historia – siç thuhet – nuk bëhet me "sikur", lexuesit e sotëm kanë të drejtën të pyesin: Po sikur, në vitin e largët 1931, të 1.250 profesorët universitarë t'i kishin thënë "jo" betimit fashist, pranimit për t'u nënshtruar dhe, si rrjedhim, për të nënshtruar të tjerët?

Të kuptohemi: "betimi" nuk do të thotë se ata që e kryen atë u bënë të gjithë fashistë të mirëfilltë dhe prodhuan nëpër auditorë "fashistët në seri". Komunikimi mendor profesor-student nëpër auditorë është shumë më i ndërlikuar, kjo është e sigurt.

Mirëpo mbetet pyetja: Po sikur ajo turmë e stërmadhe profesorësh të mos ia kishin lëshuar lirinë e tyre regjimit

fashist, me teknikën e tij të përmendur "çikë e nga një çikë", a do të kishte përfunduar Italia në atë katastrofë njerëzore në të cilën përfundoi?

Libra si ky i Giorgio Boattit ndihmon për të kuptuar sesi përmbyjsja e demokracive nuk ndodh vetëm me tanke ose me grushte të dhunshme shteti, por edhe duke promovuar "çikë e nga një çikë" fanatizëm mendimi dhe intolerancë mendimi, duke i trajtuar kundërshtarët e mendimit si armiq të shtetit e mandej të popullit dhe duke i skajuar nëpërmjet asaj që quhet në politologji "dhunë strukturore" të gjithë ata që mendojnë ndryshe nga pushteti. Për të përfunduar me vrasjen e lirisë.

Meqë, si lexuesit e sotëm, as vetë nuk jetoj në Italinë fashiste dhe e di që fashizmi i atëhershëm ka mbetur vetëm nostalgji, është tjetër llogaria që ma provokon historia e të dymbëdhjetëve në rrethana gjithnjë aktuale: Ç'fuqi mund të ketë refuzimi i vetëm 12 profesorëve përkundrejt nënshtrimit të 1.238 të tjerëve?

Një fuqi morale relative, jo më shumë: këtë përgjigje dha historia. Për të ruajtur lirinë – liritë në i daçi në shumë – nuk mjaftuaka qëndresa e disa shumë të pakëve, sado e guximshme dhe e vendosur qoftë ajo. E ka të kotë një shoqëri nëse shpreson ta shpëtojë lirinë e vet vetëm falë qëndresës së atyre disa shumë të pakëve. Për ta thënë ndryshe: nuk mund t'u ngarkohet vetëm disa shumë të pakëve marrja përsipër e përgjegjësi të një shoqërie të tërë.

IRENA BEQIRAJ

Shumica e njerëzve mendojnë se korrupsioni ka të bëjë me një politikan që merr ryshfët, ose një zyrtar publik që përveçson para. Por ka një formë më të thellë dhe më të rrezikshme të korrupsionit, që është kapja e shtetit. Ndërsa korrupsioni i zakonshëm administrativ thyen rregullat, kur ndodh kapja e shtetit, korrupsioni i rishkruan ato.

Kapja e shtetit është faza kur oligarkët, kompanitë, rrjetet kriminale e shëndërrojnë makinerinë e demokracisë në një mekanizëm për pasurimin dhe pushtetin e tyre. Në këtë fazë teknikisht tentohet që aktivitetet korruptive të mbrohen me ligj, edhe qeveria nga një qeveri "për popullin" të transformohet në një kompani që synon maksimizimin e fitimit. Në kushtet kur korrupsioni rishkruan ligjet, qarkullimi i parasë bëhet nevojë edhe braktisja e të mirës publike domosdoshmëri.

Në shtetin e kapur menaxhimi i pronës publike riorganizohet në mënyrë të tillë që shfrytëzimi i pronës publike të kanalizohet vetëm në disa duar duke anashkaluar rregullat e transparencës edhe llogaridhënies. Vetëm vitet e fundit kemi përjetuar me 10 - ra raste ku pa garë, pa transparencë, e pa llogaridhënie, Korporata e Investimeve ka

vepruar si një instrument përqendrimi edhe përveçsimit sistematik i aseteve publike.

Në shtetin e kapur, ligji përdoret si instrument nxitës i njëanshëm për transferimin e pronës pa procedurë garuese e pa transparencë nga publiku edhe qytetarët e thjeshtë tek një grup i caktuar kompanish që jo fare çuditërisht janë edhe përfitues të kontratave të tjera publike.

Që nga viti 2015 me anë të ligjit të Investimeve Strategjike qeveria ka transferuar tek investitorët strategjikë mbi 5.8 km² tokë bujqësore dhe truall kryesisht në zonën e çmuar bregdetare jugore, përmes kontratave të qirasë 1 euro (pa përfshirë Sazanit dhe Zvernecin). Po me ligj është dëmtuar edhe më rëndë prona private e qytetarëve të thjeshtë duke transferuar atë me vlera qesharake në duar të oligarkëve. Prsh, me anë të ligjit të miratuar përgjatë vitit 2020 "Për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare" qeveria u ka hequr pronarëve të tokave në bregdet të drejtën për shitjen apo zhvillimin e lirë të tokave të tyre duke i dhënë shtetit të drejtën e parablerjes të çdo toke private në bregdet ose duke i detyruar pronarët që zhvillimi i tyre mund të

bëhet vetëm me kontrata PPP ose si investim strategjik.

Po ashtu në shtetin e kapur shtrembërimi i procedurave të prokurimit kryhet lehtësisht me anë të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) të cilat përdoren si instrument për të forcuar lidhjet midis politikanëve dhe aktorëve privatë, duke shërbyer si mjete për legjitimimin e korrupsionit. Shembuj ekselent të përdorimit të ndërmarrjeve shtetërore për të transferuar prona dhe para publike pa procedurë tek privati janë Kayo edhe rrjeti i kompanive të krijuara nën të, iniciativa për transferimin e aktivitetit të AKSHIT tek një kompani tregëtare me pjesëmarrje shtetërore, apo AIR ALBANIA e falimentuar tani më.

Ndërsa treguesi përfundimtar i kapjes së shtetit është çmontimi i qëllimshëm i mekanizmave që i mbajnë zyrtarët publikë përgjegjës për menaxhimin e aseteve shtetërore. Kjo përfshin dobësimin e organeve të drejtësisë dhe gjyqësorit.

Kapja e shtetit është mutacioni më i rrezikshëm i korrupsionit: aty korrupsioni qeveris, korrupsioni legjitimon, korrupsioni blen heshtjen. Sa më shumë konsolidohet kapja e shtetit aq

më shumë dëmet janë të pakthyeshme, dhe reformat kthehen thjesht në morfina që qetëson dhimbjet e degradimit.

Por le të jemi të sinqertë, kapja e shtetit nuk është vetëm vepër e individit që drejton shtetin, në fakt janë elitat me veprimet ose mos veprimet e tyre mundësuesit kryesorë të kapjes së shtetit.

Përtej mercenarëve partiakë të Kuvendit, të cilët çertifikojnë çdo ditë kapjen e shtetit, janë gjykatësit, ekonomistët, pedagogët e universiteteve, analistët, gazetarët ekspertë, emisionet televizive të dedikuara, që ndërtojnë edhe shpërndajnë narrativat që justifikojnë veprimet e kapjes së shtetit. Janë atë që ofrojnë në opinionin publik kornizën ideologjike që justifikon "përdorimin" e institucioneve shtetërore për t'i shërbyer interesave të ngushta.

Po ashtu që aktivitetet korruptive të duken të ligjshme, nuk mjafton Taulanti, Ulsi, Zeqineja, Sara, Zaira, apo edhe Bajram Bega, nevojitet përfshirja e avokatëve, ekspertëve të politikave konsultive për të hartuar legjislacione politike ose transaksione që favorizojnë interesa specifike. E pra janë elitat të cilët

hartojnë korniza komplekse, në dukje ligjore, që lehtësojnë transferimin e burimeve publike në duar private.

Sikurse ishin ekspertë ato që u rekrutuan për të mbushur komisionin parlamentar antikorrupsion duke siguruar legjitimin e tij edhe duke maskuar qëllimin e vërtetë të tij.

Jo vetëm nga aftësitë djallëzore individuale të kryeministrit edhe as vetëm për paaftësinë e opozitës për t'u bashkuar në një front, por edhe për pjesëmarrjen aktive të një armate elitare shpirtshitur në kapjen e shtetit, zgjedhjet janë kthyer në rituale boshe, dhe shqiptarët e gjejnë veten duke jetuar në një shtet që duken si demokraci në letër, por në realitet funksionon si kartel.

Shteti i kapur është një përplasje midis vullnetit publik dhe pushtetit politik, një përplasje që nuk mund të injorohet, edhe nuk mund të minimizohet në një detyrë thjesht partiake.

Për t'i shpëtuar pushtimit nga të korruptuarit përtej një opozitë partiake që synon të vijë në pushtet ne kemi nevojë për vullnet publik, për një elitë intelektuale civile e cila është aktive edhe e gatshme të mbrojë me njohuri, besim edhe guxim, nevojën e demokracisë për mirëqeverisje.

KAPJA E SHTETIT EDHE ELITAT SHPIRTSHITURA!

MERI LIKA

Edhe pse mes bilanceve e mbylljeve vjetore, kur në këtë kohë çdo minutë për mua është flori, e pata të pamundur të mos shkruaja disa shifra në lidhje me të sëmuren e madhe në radhën e rrugëve që janë shtrirë në agoni gjatë sipërfaqes së vendit tonë.

Korça u nda, jo se do t'i bashkohet Francës, nga "inati" që e kemi quajtur "Parisi i Shqipërisë", por nga dëshira e madhe e qeverisë për korrupsion.

Retorikës "Fajin e ka Saliu" sot unë do t'i drejtohem totalisht me shifra, jo nga ato që prodhon Bela, Elisa apo edhe Zeqineja, por nga ato që ka prodhuar në gjithë këto zbrazja e buxhetit të shtetit në tenderat e kësja ruge.

Korridorin VIII është një nga akset që mendohet të lidh Detin Adriatik (përmes Durrësit) me Detin e Zi (përmes Varnas), duke kaluar përmes Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë.

Kjo "arterie" ka qenë pjesë e strategjisë së integritimit evropian për vite me radhë, por tenderat dhe ndërtimet konkrete në Shqipëri nisën realisht në fillim të viteve 2020 si pjesë e prioritetëve të qeverisë për t'i dhënë një formë moderne infrastrukturës rrugore.

Data e parë e një tenderi me peshë dhe vlerë konkrete ishte në fund të vitit 2022. Më 9 nëntor 2022, Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) shpalli tenderin "Zgjerim i rrugës Elbasan-



Qafë Thanë, Faza 1" me vlerë rreth 2,620,000,000 ALL (afërsisht 26 milionë Euro), i cili u fitua nga firma ALB-BUILDING shpk. Kjo garë konsiderohet projekti i parë masiv rrugor për këtë vijë, pasi synonte modernizimin e segmentit rrugor që lidhet drejt Librazhdit dhe më tej drejt pjesëve juglindore të vendit. Në dokumente zyrtare ky tender është quajtur si faza e parë e një projekti me disa faza të ndara, jo një kontratë unike

lineare deri në Korçë.

Kur u shpall ky tender, ai u prezantua nga autoritetet si një ndërhyrje themelore për të larguar nyjet e ngarkuara trafiku, për të zgjeruar rrugën dhe për ta përgatitur kuadrin rrugor drejt pjesëve lindore të vendit. Synimi kryesor teknik ishte zgjerimi, stabilizimi dhe rritja e kapacitetit të segmentit deri në Qafë Thanë, që është një pikë kyçe kufitare dhe nyje

strategjike për trafikun rajonal.

Tenderi i vitit 2022 u bë me procedura të tjera të ndara, ku u përfshinte faza të tjera të Korridorit VIII, përfshirë lotet V, VI, VII dhe VIII të segmentit Elbasan-Qafë Thanë, secili me fond limit rreth 2.5 miliardë lekë (afërsisht 25 milionë Euro secili pra 100 milion euro) për secilin lot. Këto janë tenderë të shpërndarë, jo një kontratë e vetme e madhe.

Sipas raportimeve financiare për vitin 2025, janë paguar rreth 98 milionë euro për segmentet e Korridorit VIII në territorin shqiptar, përfshirë punimet në drejtim të Elbasan-Librazhd dhe Elbasan-Qafë Thanë. Pra kjo rrugë e cila na shërbeu vetëm për të ndarë verilindjen e Shqipërisë ka kushtuar:

Tenderi i parë (2022) afërsisht 26 milionë Euro

4 lote pasuese afërsisht 100 milionë Euro

Pagesa për Korridorin VIII vetëm në 2025 afërsisht 98 milionë Euro

Investime totale të deklaruara për Korridorin VIII (2019-2025) afërsisht 700 milionë Euro

Kësaj shume duhet t'i shtojmë edhe kostot e supervizionit:

- Supervizion punimesh – Zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë (Faza VIII) 206 mijë Euro

- Supervizion punimesh – Zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë (Faza V) 238 mijë Euro

Në fund na mjafton vetëm një makinë llogaritëse për t'i mbledhur këto shifra.

Dotech

website 

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946




Mob: 078 5997 7545



The Albanian

Dotech

website 



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

**Akoma nuk jeni
rregjistruar në
Google?**



Our Services:

- WEBSITE DESIGN
- Business Cards
- Banners
- Flyers
- Video Marketing

Contact Us 



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT



Një sistem i ri udhëtimi për vizitorët në Mbretërinë e Bashkuar hyn në fuqi nga e mërkura për qytetarët e dhjetëra vendeve si SHBA-ja dhe Australia.

Qeveria thotë se autorizimi elektronik i udhëtimit (ETA) do të përmirësojë sistemin e imigracionit.

Megjithatë, kjo ka krijuar probleme për personat me shtetësi të dyfishtë, të cilët janë përpjekur të marrin një pasaportë britanike për të ndjekur rregullat e reja.

Çfarë është një ETA dhe kujt i duhet një e tillë?

Një ETA është një leje dixhitale për të udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar.

Nga 25 shkurti, shumica e njerëzve që kanë mundur të udhëtojnë në Mbretërinë e Bashkuar pa viza deri më tani do të kenë nevojë për një orar mbërritjeje.

Rregullat e reja zbatohen për njerëz nga 85 vende të ndryshme.

Pasi të miratohet, ETA juaj do t'ju lejojë të qëndroni në Mbretërinë e Bashkuar deri në gjashtë muaj. Do të jetë e vlefshme për dy vjet, ose derisa të skadojë pasaporta juaj, dhe lejon udhëtime të shumta në Mbretërinë e Bashkuar.

Vizita mund të jetë për gjëra të tilla si turizëm, biznes ose studim afatshkurtër.

Mund të jetë gjithashtu për njerëzit që kalojnë kufirin dhe udhëtojnë nëpër Mbretërinë e Bashkuar si pjesë e një udhëtimi, megjithëse njerëzit që kalojnë tranzit nëpër aeroportet e Mbretërisë së Bashkuar dhe që nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër sigurinë kufitare nuk do të kenë nevojë për një ETA.

Udhëtimet dhe vizitat më të gjata për punë ose studime më të gjata do të kërkojnë vizë.

Personat që zakonisht kanë nevojë për vizë për të udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar do të kenë ende nevojë për vizë për të udhëtuar në Mbretërinë e Bashkuar. Ata nuk do të kenë nevojë të aplikojnë për një ETA gjithashtu.

Qytetarët britanikë ose irlandezë nuk do të kenë nevojë për një ETA ose vizë për të vizituar Mbretërinë e Bashkuar ose për të udhëtuar nëpër të. Ka disa përjashtime të tjera, siç janë ata me status të vendosur ose fëmijët që udhëtojnë nga Franca për një ekskursion shkollor.

Skema u lançua në tetor 2023, por qeveria thotë se “nuk u zbatua në mënyrë strikte për t'u dhënë vizitorëve kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me kërkesën e re”.

Megjithatë, në nëntor, qeveria tha, Mjetet e mbërritjes (ETA) do të jenë të detyrueshme nga 25 shkurti.

Qeveria thotë se ETA-të do ta thjeshtojnë sistemin e imigracionit, do ta

CILI ËSHTË SISTEMI I RI I UDHËTIMIT NË MBRETËRINË E BASHKUAR DHE SI PREKEN PERSONAT ME SHTETËSI TË DYFISHTË?



përshejtojnë atë dhe do ta bëjnë më të sigurt.

Si mund të marr një ETA dhe sa kushton?

Marrja e një ETA kushton 16 paund, por qeveria ka thënë se planifikon ta rrisë tarifën në 20 paund në të ardhmen.

Për të aplikuar, qeveria rekomandon shkarkimin e aplikacionit nga Google Play, i jashtëmose Apple App Store.

Do t'ju duhet të jepni të dhënat e kontaktit dhe të pasaportës, një foto të përshtatshme dhe t'u përgjigjeni një sërë pyetjesh.

Duhet të udhëtoni duke përdorur të njëjtën pasaportë që përdoret kur aplikuat për ETA.

Qeveria thotë se shumica e njerëzve do të marrin një përgjigje automatike brenda pak minutash kur përdorin aplikacionin ETA, por u rekomandon njerëzve të aplikojnë të paktën tre ditë pune para udhëtimit.

Nëse kërkesa e një personi për ETA refuzohet, qeveria thotë se atij do t'i tregohet arsyeja dhe ai mund të aplikojë përsëri.

Megjithatë, nëse kërkesa e një personi për leje qëndrimi (ETA) refuzohet,

ai/a jo nuk mund të apelojë dhe në vend të kësaj duhet të aplikojë për vizë për të vizituar Mbretërinë e Bashkuar.

Si do të zbatohen rregullat? Kur të regjistroheni për udhëtimin tuaj, mund të mos jeni në gjendje të hipni në aeroplan pa një kohë mbërritjeje të vlefshme.

Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar u ka dhënë linjave ajrore, kompanive hekurudhore dhe kompanive të transportit detar mjete për të verifikuar lejen e udhëtimit përmes kontrolleve automatike dixhitale me Ministrinë e Brendshme.

Një ETA është e lidhur dixhitalisht me pasaportën tuaj, kështu që nuk keni nevojë për një kopje letre në kufi. Megjithatë, qeveria thotë se mund të dëshironi të mbani një kopje letre për të dhënat tuaja gjithsesi.

Ndërkohë që një ETA ju jep leje për të vizituar Mbretërinë e Bashkuar, nuk ju jep të drejtën për të hyrë. Pra, do t'ju duhet të kaloni kontrollin e pasaportave.

Mund të refuzoheni në kufi edhe me një kohë mbërritjeje të vlefshme nëse ka probleme të tjera në kontrollin e pasaportave.

Cili është problemi për personat me shtetësi të dyfishtë?

Personat me shtetësi të dyfishtë – ata që janë shtetas si të Mbretërisë së Bashkuar ashtu edhe të vendeve të tjera – nuk mund të marrin një ETA.

Për të hyrë në vend, ata do të duhet të paraqesin ose një pasaportë britanike ose një version të ri dixhital të certifikatës së të drejtës për ta bashkëngjitur pasaportës së tyre të kombësisë së dytë.

Pa njërin prej tyre, ata mund të përballen me mohimin e së drejtës për të udhëtuar përsëri në Mbretërinë e Bashkuar.

As pasaportat britanike dhe as certifikatat e të drejtës nuk u lëshohen automatikisht personave që marrin shtetësi, që do të thotë se disa persona me shtetësi të dyfishtë nuk kanë aplikuar kurrë për to, edhe nëse kanë jetuar në Mbretërinë e Bashkuar për dekada të tëra.

Të dy dokumentet duhen disa javë për t'u marrë, dhe ka edhe kosto. Një pasaportë britanike kushton rreth 100 paund për një të rritur, ndërsa certifikata e të drejtës kushton 589 paund.

Më parë, personat me shtetësi të dyfishtë kishin mundur të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar dhe të kthe-

heshin duke përdorur pasaportën e tyre jo-britanike.

Disa britanikë me shtetësi të dyfishtë i kanë treguar BBC-së për vështirësitë e tyre për të marrë një pasaportë britanike për të përbushur kërkesat e reja.

Disa kanë qenë jashtë vendit që kur është njoftuar ndryshimi i rregullave dhe thonë se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me ndryshimet.

Një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme i tha më parë BBC-së se “informacioni publik që këshillon personat me shtetësi të dyfishtë të mbajnë dokumentet e sakta ka qenë i disponueshëm që nga tetori 2024 dhe një fushatë thelbësore komunikimi në lidhje me futjen e ETA-s ka qenë duke u zhvilluar që nga viti 2023”.

Cilat vende të tjera përdorin ETA-të? Nëse ETA ju tingëllon e njohur, kjo ndodh sepse Kanadaja, SHBA-ja dhe vende të tjera e përdorin tashmë sistemin.

Megjithatë, kostot ndryshojnë.

Një ETA kanadeze kushton vetëm 7 dollarë kanadezë (3.78 £), ndërsa ekuivalenti amerikan do t'ju kushtojë 40.27 dollarë (29.75 paund).



udhëtimi 

The Albanian

Promovimi i shqiptarëve të suksesshëm të Britanisë

udhëtimi 

Të dashur miq/mikesha

Faleminderit për të gjitha sygjerimet, për historitë e shqiptarëve të suksesshëm të Britanisë.

Ky është dhe do të mbetet, misioni themelor i "The Albanian"

A nuk jeni ju, sipërmarrësit shqiptarë të Britanisë, modeli i ngadhënjimit, i punës dhe sakrificës, duke u shndërruar në ambasadorët më të shkëlqyer të kombit shqiptar, që na bëni krenar çdo ditë?

Ju, që kur filluat sipërmarrjen, mbase nuk kishit veçse një çantë me ëndrra, por që sot shkëlqeni dhe që, krejt natyrshëm, jeni duke shërbyer si modele frymëzimi për brezin e ri në Britani dhe jo vetëm.


Gjithsecili prej jush ka një histori për të rrëfyer.

Ju lutem na kontaktoni si dhe na sygjeroni këdo që ju mendoni se ka histori të jashtëzakonshme, rrëqethëse, por që ka ngadhënjyer.

Ne do t'i kontaktojmë dhe do t'i pasqyrojmë historite e tyre, qoftë me video apo print dhe online.

Ju faleminderit!

Stafi "The Albanian"



...me historitë

e shqiptarëve të suksesshëm në Britani...

Adresae Zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT

Tel:02070187929 Mob: 0734066 5946

Mob: 078 5997 7545

REXHEP QOSJA

Brezi im ka pasur fat të jashtëzakonshëm që prej natyrës të jetë i dhuruar me një vetje siç është Adem Demaçi. E thashë brezi im e do të duhej të thosha se Kosova, në të vërtetë populli shqiptar në përgjithësi, ka pasur fat të madh që ka rritur një vetje siç është Adem Demaçi.

Pse mund të thuhet kështu?

Mund të thuhet kështu sepse Adem Demaçi është autoritet i madh, i pakrahasuar me askënd tjetër në Kosovë para tij dhe pas tij: autoritet politik, kulturor e moral.

Dhe, ky autoritet me kohë është bërë autoritet gjithëkombëtar dhe është bërë autoritet i tillë sepse është ndër-tuar mbi përkushtimet e tij jo ndaj një, por ndaj disa veprimtarive kombëtare: ndaj krijimtarisë letrare, ndaj publicistikës, ndaj veprimtarisë politike.

Në të gjitha këto veprimtari ai do të merret me çështje thelbësore nga e shkuara, nga e përtashmja dhe nga e ardhmja e popullit shqiptar.

Shikimet e tij dhe shpjegimet e tij të fatit historik, politik, shoqëror, kombëtar të Kosovës dhe të të gjithë shqiptarëve kurrë dhe kurrkund s' do të shprehen me mënjani mendore e ndjenjore, por me mospajtim të theksuar me gjendjen e përtashme dhe me padrejtësitë historike që i ishin bërë atyre, me mospajtime me pasojat që populli shqiptar po përjetonte për shkak të atyre padrejtësive të kryehershme, me mospajtime që do të ndërtojnë dhe frymëzojnë vetëdijen e re të rinisë sonë.

Ishin këto shikime dhe shpjegime që shpreheshin me gjuhë letrare artistike në prozën e tij: në romanet dhe në tregimet e tij.

Ishin këto shikime dhe shpjegime që shpreheshin me gjuhë intelektuale në shkrimet e tij publicistike.

Ishin këto shikime dhe shpjegime që shpreheshin qoftë edhe me programe kombëtare në veprimtarinë e tij të pandalshme politike.

Me këto shikime dhe shpjegime Adem Demaçi do të bëhet herët shqiptues i madh, më i madhi, në historinë shqiptare të Kosovës, i mendimit të guximshëm, të drejtë, të ndershëm, i mendimit çlirimtar shqiptar.

E gjithë kjo veprimtari e gjithanshme artistike, shoqërore dhe politike, që ishte plotësisht mospajtuese me politikën zyrtare kosovare, serbe e jugosllave dëshmon qartë se Adem Demaçi ia kishte dhuruar jetën Kosovës, se ia kishte dhuruar jetën lirisë dhe pavarësisë së saj, se ishte i gatshëm të fllohej për të.

Si do t'i përgjigjet Kosova kësaj gatishmërie flijuese të Adem De-

DROJA E TYRE PREJ LAVDISË SË ADEM DEMAÇIT



maçit. Të shprehem më saktësisht: si do t'i përgjigjen udhëheqjet politike të Kosovës kësaj gatishmërie flijuese të Adem Demaçit?

Përgjigjja është dëshpëruese.

Në kohën e ish Jugosllavisë komuniste ato udhëheqje do t'i përgjigjen duke iu bashkuar udhëheqjeve serbe dhe jugosllave në burgosjet e gjykimet e tij tri herë për veprimtari armiqësore, që do t'ia shqiptojnë rreth njëzet e tetë vjet burgje?

Më vonë, në kohën e veprimtarisë së një vargu partish shqiptare në Kosovë prej fillimit të vitit 1990 e deri në vitin e çlirimit të Kosovës prej pushtimit të Serbisë, udhëheqjet partiake të këtyre partive, që po bënin të ashtuquajturën politikë paqësore, do t'i përgjigjen me drojë të madhe prej autoritetit të Adem Demaçit dhe me përpjekje të gjithfarshme me shkrime në gazetata e kontrolluara prej tyre dhe me propagandë gojore të palejueshme me çka synohej zhvlerësimi i autoritetit dhe i meritave të tij!

Po të lexohen sot gjithë ato që në gazeta janë shkruar kundër tij do të mund të bindemi se sa e paskrupuj ishte droja prej mundësisë që Adem Demaçi të ngrihej në rolin që në sytë e popullit në të vërtetë ishte: në rolin e prijësit të Lëvizjes për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës!

E tani, pas luftës çlirimtare, pas sendërtimit të idealit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, të cilit ai ia kishte flijuar pjesën më të rëndë-

sishme, më të vlefshme të jetës së tij, si do ta trajtojnë Adem Demaçin udhëheqjet politike të shtetit të Kosovës.

Kryetari i lavdishëm amerikan Xhon Kenedi ka thënë: "Mos pyet çka ka bërë atdheu yt për ty, por pyet çka ke bërë ti për atdheun". Ky mendim aq shumë i cituar prej politikanëve e intelektualëve të ndryshëm në botë në të vërtetë është një ndryshim i kuptimit të mendimit të njohur të poetit të madh italian, Dante Aligeri, i cili mbas syrgjynosjes prej vendit të vet – prej Firences kishte thënë: "Nuk kam vetëm unë obligime ndaj atdheut, por edhe atdheu ka obligime ndaj meje".

Është thënë se Adem Demaçi, si askush tjetër në historinë shqiptare, i ka kryer obligimet atdhetare ndaj Kosovës, por ende s'është thënë si i ka kryer obligimet e saj ndaj tij Kosova shtet?

Do të përgjigjemi ndershëm e drejt në këtë pyetje në qoftë se fatin e Adem Demaçit pas çlirimit prej burgjeve e krahasojmë me fatin e Nelson Mendelës pas lirim të tij prej burgjeve të Republikës së Afrikës Jugore.

Mbas lirim të tij prej burgut, jo vetëm bashkëmendimtarët, por edhe kundërshtarët politikë do ta shpërblejnë Nelson Mendelën me nderime, të pamatshme: do t'i caktojnë këshilltarë, do t'i caktojnë shpura, do t'i caktojnë privilegje të ndryshme politike, shoqërore, materiale, do ta bëjnë protagonist në shumë institucione shoqërore, kulturore, shkencore. Dhe,

në fund, do ta bëjnë kryetar shumëvjeçar të Republikës Jugafrikane.

Asnjë prej këtyre nderimeve politike larghedhëse që iu bënë Mendelës jugoafrikan nuk iu bënë Mendelës kosovar – Adem Demaçit.

As gjashtëmbëdhjetë vjet pas çlirimit, çmimi shtetëror i Kosovës për krijimtarë mendore, që i është dhënë shumë kujt, kujt e meriton dhe kujt s' e meriton, nuk i është dhënë Adem Demaçit!

As gjashtëmbëdhjetë vjet pas çlirimit të Kosovës Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, anëtarë të së cilës janë bërë edhe vetje pa rëndësi as politike, as shkencore, as artistike për Kosovën, nuk e nderoi veten e saj duke e pranuar Adem Demaçin!

As gjatë gjashtëmbëdhjetë vjetëve të Kosovës së çliruar Adem Demaçin nuk e bënë as deputet të përhershëm siç janë bërë në botë disa autoritete të mëdha kombëtare, nuk e bënë as deputet katërvjeçar, as kryetar të Kuvendit të Kosovës, as kryeministër e as kryetar të Kosovës! U bënë deputetë, kryetarë të Kuvendit, kryeministra, kryetarë të Kosovës vetje, që s'i kanë dhuruar asnjë pikë djersë lirisë së Kosovës, që s'i kanë kushtuar asnjë orë e asnjë fjali pavarësisë së Kosovës, por s'u bë Adem Demaçi!

Pse në Kosovë, për hir të nderimit të saj në botë, nuk u bë institucion shtetëror lavdia politike, morale, çlirimtare e 28 vjetëve burgje të Adem Demaçit?

Nuk ka dyshim se sjelljen e këtyllë


ndaj Adem Demaçit, që në thelb dëmtoi Kosovën e bënë arrivistët e pushtetshëm – ata që Adem Demaçin e xhelozuan dhe e xhelozuan për shkak të të gjitha atyre meritave historike, që ka ai për Kosovën dhe për popullin shqiptar në përgjithësi, për shkak të autoritetit madhor me të cilin ai i bën gati të padukshëm gjithë të tjerët.

Por jo vetëm kaq. Sjelljet e këtyllë përjashtuese ndaj Adem Demaçit ta themi kryetar i Kosovës i nxiti shumë më tepër droja prej etikës së tij politike me të cilën ai do të parandalonte privilegjet, korrupsionin, zhvatjet, lukset, pasurimin e lehtë, të shpejtë, të kundërligjshëm, e të këqijat e tjera në institucionet shtetërore, duke e bërë përgjegjshëm jo vetëm kulturë por edhe ligj të pashmangshëm në politikën shqiptare.

Sjelljet e këtyllë, politikisht dhe moralisht të papranueshme ndaj Adem Demaçit dhe të dëmshme ndaj Kosovës i bënë ata që me asgjë, nuk i mbërrijnë atij as deri te gjunjët.

Lejohem të them se emrat e tyre do të harrohen ditën kur do të mbesin pa karriget për të cilat bënë dhe po bëjnë edhe krejt çka s'bëhet, kurse emri i Adem Demaçit, jetëshkrimi i tij, vepra jetësore dhe mendore e tij, do të jetë e përjetshme dhe përjetshëm do ta lëvizë dhe do ta ndriçojë historinë e popullit shqiptar.

(Fjalë a mbajtur në ceremoninë me rastin e 80 vjetorit të lindjes së Adem Demaçit)



IRENA BEQIRI

Kjo pyetje shpesh shqiptohet si pyetje retorike por edhe e ngarkuar me një dozë të madhe zhgënjimi, sikur largimi i vullnetshëm të nënkuptonte brishtësi, dështim ose mungesë qëndrueshmërie e zotësie.

"Ah sikur njerëzit e mirë të kishin duruar ca më shumë, të kishin qëndruar ca më gjatë; të kishin mësuar të luajnë lojën, nuk do të ishim dëshimim-

PSE NJERËZIT E MIRË NUK QËNDROJNË NË POLITIKË?

tarë të rënimit të politikës edhe lidërshipt në këtë derexhe " ky është arsyetimi me të cilin përballim sa herë flas për largimin vullnetar nga qeveria . Por ky këndvështrim keqkupton problemin. "Njerëzit e mirë "nuk u larguan nga politika sepse nuk mund të përballonin presionin. Ata u larguan pasi kuptuan se çfarë shpërblente e çfarë ndëshkonte në heshtje sistemi i ngritur .

Kur flas për "njerëz të mirë", nuk nënkuptoj as shenjtorë e as superheronj, por me dhjetra individë të larguar sepse vendosën të drejtohen nga parimet jo nga statusi, fama ose pushteti. Njerëz që përjetuan

shqetësim të vërtetë kur ju kërkohej të shkëmbenin integritetin me përshatshmërinë politike; njerëz që sapo vunë re se hendeku i thellë midis retorikës publike dhe qëllimeve së qeverisë nuk mund të njoorohej, reagues . Në qeveritë e rilindjes pa asnjë përjashtim që nga e para e deri tek e fundit integriteti lëvdërohet retorikisht, por nuk mbrohet institucionalisht. Nëse kundërshton je naiv ose më keq konfliktual; nëse ngre shqetësimet etike, të thuhet"që ende nuk e kupton se si funksionojnë gjërat" . Në të zotësia lidhet me aftësinë për të toleruar sjellje edhe veprime që janë tërësisht të papranueshme. Aty zotësi do të thotë të mësosh të ulesh i

pashqetësuar në tavolina ku vendimarrjet nuk drejtohen nga interesi publik por nga pozicionimi personal në lidhje me liderin ; do të thotë të pranosh që rezultatet kanë pak ose aspak rëndësi edhe mbijetesat është gjithçka. Ata që për hir të statusit edhe pushtetit masterizuan këto "zotësi" mbijetuan . Ata që i refuzuan këto zotësi edhe publikisht, u etiketuan si mosmirënjohës apo tradhtarë të familjes politike .

Bernard Russell na kujton se: "njeriu ka bërë një jetë të denjë kur e ka parë botën përtej interesave personale", edhe tragjedia e të mbijetuarve në politikë edhe qeverisje (aty fatkeqë-

sisht ka akoma njerëz të dashur për mua) nuk është se ata dinë gjithnjë e më pak për kuptimin e jetës së denjë , por se kuptimi i një jete të denjë i shqetëson ata gjithnjë e më pak. E pra , largimi nga politika nuk është një heqje dorë, por një akt integriteti. Jo të gjithë janë të destinuar të mbijetojnë në mjedise ku fleksibiliteti moral shpërblehet edhe vlerësohet mbi qartësinë morale.

Sa mirë që ka akoma ndër nesh modele njerzish që refuzojnë të mbijetojnë në këto mjedise, si një kujtesë a provë që ky mjedisi politik duhet ndryshuar .

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



Shpresa Programme

Inspiring hope & change

VOLUNTEERS NEEDED!

WE NEED YOUR HELP!

Are you passionate about making a difference in people's lives? Do you want to help individuals facing challenges such as housing issues, welfare benefits, debt, immigration, and more?

We are looking for dedicated volunteers to join our Advice & Advocacy Team. This is a fantastic opportunity to gain hands-on experience, receive specialist training, and help increase our capacity to support vulnerable clients.

Contact us!

020 7511 1586
SHPRESAPROGRAMME@YAHOO.CO.UK
SHPRESAPROGRAMME.ORG

ANDI BUSHATI

Dyzimi përballë të cilit gjendet është nervëshkatërues: nga njëra anë Ramës i duhet ti vërë fre spak-istëve që deri më tani i ka pasur nën hyqëm, por që dyshon se padronë të rinj mund ti'a nxjerrin nga vatha. Nga ana tjetër, i duhet mburoja e nxënësit të bindur të ndërkombëtarëve që i ka siguruar legjitimitet për një kohë të gjatë

Përpëlítja gati tre mujore e Edi Ramës për të mbrojtur me çdo kusht Belinda Ballukun si dhe shkuarja më tej, për të prodhuar ligje të reja që forcojnë paprekshmërinë e bashkëpunëtorëve, po përvijohet si një test interesant për të vëzhguar marëdhënien e tij të re me BE-në. Disa sinjale tashmë janë dhënë.

Në një pjesë të mirë të mediave më në zë ndërkombëtare, protestat para kryeministrit, nuk përshkruhen më si manifestime të opozitës, por si reagim i qytetarëve kundër korrupsionit, ku në të gjitha rastet zv/kryeministria nuk harrohet të përmendet nominalisht. Edhe institucionalisht reagimet nuk kanë munguar.

Në fund të janarit, gjatë një mbledhjeje në Bruksel, të Grupit të Punës për Zgjerimin dhe Vendet që Negociojnë Anëtarësimin në BE, Shqipërisë iu dha sinjali i qartë se, rruga e integritimit mund të pësonte ngecje.

Më pas, Komisioni kërkoi në mënyrë ultimative shqyrtimin e imunitetit të Ballukut, që shumica qeveritare po e zvarritte.

Gjatë vizitës së fundit në Tiranë, kreu i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Evropian, David McAlistër, në sinkron me ambasadorin Gonzato, përmendën se rasti Balluku nuk është thjeshtë një çështje juridike, por se në të kundërt ngërthen edhe "përgjegjësi politike".

Disa vende anëtare të kryesuar nga Gjermania e të mbështetur edhe nga Holanda e Franca kanë ngritur shqetësimin se me rastin e zv/kryeministres, me fjalorin e përdorur kundër gjykatësve dhe prokurorëve si dhe me ndryshimet ligjore që parashikohen të bëhen për të mbrojtur politikanët e lartë, qeveria e Tiranës rezikon të çënojë investimin më të madh të evropianëve, reformën në drejtësi, që ata vijnë ta konsiderojnë me kokëfortësi si një "histori suksesi".

Në fakt, në mbretërimin e gjatë të Edi Ramës ky nuk është momenti i vetëm



i fërkimeve me BE-në dhe shtetet kryesore anëtare. Vitet 2018- 2020, kur vendit i mohohej në vijimësi hapja e negociatave dhe kur disa parakushte të Bundestagut Gjerman u shndërruan në 15 kushtet e Parlamentit Evropian (që përfshinin dënimin e vjedhësve të votës së Durrësit dhe Dibrës, ndëshkimin e politikanëve të lartë dhe ndërprerjen e betejës me mediat), kanë qenë tepër të vështira për të.

Atëhere jo vetëm ishte vënë në pikpyetje e ardhmja evropiane e vendit por edhe vetë reputacioni i qeverisë që e drejtonte.

Falë një lobingu të fuqishëm, luftës për shkatërrimin e çdo rivaliteti politik të brendshëm dhe sidomos prej ndryshimit të kontekstit gjeopolitik pas konfliktit në Ukrainë, Rama arriti ta përmbysë këtë tendencë në favor të tij.

Por, të gjitha këto ndodhi dhe lëvizje nuk do të kishin pasur asnjë vlerë, nëse ai nuk do të kishte përdorur me sukses një atu: atë të vetmit politik që mbështeteste reformën në drejtësi, kundërt një opozitë që ishte shpallur hapur kundër saj.

Ndonëse ia dinin korrupsionin, kanabizimin, tendencat autoritare, ndonëse mediat dhe shërbimet inteligjente i informonin qeveritë e tyre me fakte për atë që ndodhte realisht në Shqipëri, Rama kish arritur të shpëtonte nga luajtja mrekullisht e rolit të

aleatit të dëgjueshëm që nuk kundërshton.

Si nëpër filma me agjentë të luftë së ftohtë, ai përfitonte nga sllogani: "Është vërtet një bir kurve, por është biri ynë i kurvës".

Pyetja është, po tani? Ç'ndodh nëse kryeministri heq dorë nga tabuja e paprekshmërisë së reformës në drejtësi? Nëse ai prodhon ligje për mbrojtjen e ministrave të tij? Nëse ai i bëhet pengesë drejtësisë për rastin Balluku?

I vetmi sistem që ne kemi për të "lexuar" të ardhmen është të kuptojmë si BE-ja është sjellë në të shkuarën. Kur ish partia në pushtet në Rumani, kërkoi të ndryshonte ligjet për të mbrojtur liderin e saj nga SPAK-u lokal, nuk arriti dot asgjë dhe presioni ndërkombëtar bëri që Liviu Dragnea të përfundojë gjithësesi në burg.

E njëjta fabul u përsërit edhe në një vend tjetër anëtar, në Poloninë e drejtuar nga konservatorët e partisë Ligj dhe Drejtësi (PiS). Me të ardhur në pushtet ata synuan një reformë që tentonte një ndikim më të madh politik mbi sistemin e drejtësisë.

Ndonëse një vend i rëndësishëm për BE-në, Polonia u përball për herë të parë në histori me aktivizimin e nenit 7, për heqjen e të drejtës së votës (2017), Varshavës iu vendosën gjoba ditore dhe iu bllokuan miliarda euro fonde nga plani i rimëkëmbjes (2021).

Të gjitha këto goditje, pa precedent, kishin një shpjegim: mos krisjen e fasadës që e ruan drejtësinë të pavaruar nga politika.

Pikërisht, respektimi i këtij parimi ka qenë edhe amnistimi më i fortë i të gjitha mëkateve të Ramës në sytë e Brukselit. Atij i është harruar pothuajse gjithçka falë talentit për ta paraqitur veten si i vetmi partner lokal që ndihmon implementimin e reformës në drejtësi.

Por, historia e sigurimit të kësaj mburoje, duke bërë rrugës kurban ata që i kanë ndenjur në krah dhe i janë bindur urdhërave të tij, do të mbërrinte, një ditë, tek një tavan i pakapërcyeshëm.

Sot, Ramës po i kërkohet të dorëzojë krahun e vet të djathtë të akuzuar, si asnjëherë më parë, për procedura ku ai është kokë e këmbë i përfshirë personalisht. Prandaj dilema që ka këtë herë është më e fortë: a duhet të vazhdojë ta mbajë të ndezur dritën jeshile për SPAK dhe GJKKO?

A mos vallë po pranoi parimin e pezullimit, do të hapë atë rrugë që një ditë mund të sjellë fundin e vet?

A thua po i lëshoi pe heqjes së çdo imuniteti, do të trokasin edhe në derën e tij?

Dyzimi përballë të cilit gjendet është nervëshkatërues: nga njëra anë i

duhet ti vërë fre spak-istëve që deri më tani i ka pasur nën hyqëm, por që dyshon se padronë të rinj mund ti'a nxjerrin nga vatha.

Nga ana tjetër, i duhet mburoja e nxënësit të bindur të ndërkombëtarëve që i ka siguruar legjitimitet për një kohë të gjatë.

Pikërisht, ngaqë nuk ka vendosur se cilën rrugë do të zgjedhë Rama e ka bërë tërkuzë imunitetin e Ballukut, pa thënë kurrë, në mënyrë të prerë nëse, do e dorëzojë apo jo; për të njëjtën arsye ai njëherë turfullon e shan gjykatësit e prokurorët, pastaj u rrezervon atyre paqe, shoqëruar me heshtje të gjata; fiks për këtë projektin ndryshime ligjesh që garantojnë paprekshmëri, por heziton ti votojë ato më urgjencë në kuvend.

Nga kahu që do të marrë në këtë udhëkryq, do të varet e ardhmja e tij. Jo ajo e një kryeministri, vendi i të cilit mëton një integritet të shpejtë në BE. Aq më pak ajo e fabulës me të cilën "fitoi" zgjedhjet e fundit. Por, thjeshtë ajo personale.

Prandaj dhe Rama është i dyzuar, pasi e di që dosja Balluku e ka detyruar të paguajë një çmim: ose atë të fundit të fabulës prej nxënësi të bindur të ndërkombëtarëve, ose tjetrin, që me riskun e ruajtjes të së parës, ta dorëzojë fatin e vet politik, krejt i pambrojtur, në duart e tyre.

Dotech

websites

UPGRADE YOUR WEBSITE

100%
Trusted

I jepni biznesit tuaj një faqe moderne, të shpejtë dhe të lehtë për t'u përdorur, e cila i shndërron vizitorët në klientë. Ne e ridizenjojmë, optimizojmë dhe përmirësojmë faqen tuaj për të rritur performancën, dukshmërinë dhe ndikimin.

Our Services

- ✓ Custom web design
- ✓ E-commerce setup
- ✓ Mobile optimization
- ✓ Website maintenance
- ✓ SEO structure

Build a website that works beautifully fast and converts visitors into customers.

NA KONTAKTONI

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



VISAR ZHITI

Tani nga Haga erdhi një pretendë nga më të rëndat, jo vetëm për drejtësinë ndërkombëtare, por edhe për kujtesën historike të luftës çlirimtare të një populli në Europë, të shqiptarëve në Kosovë.

Prokuroria kërkoi 45 vjet burg për Hashim Thaçin, 45 vjet burg Kadri Veselin, 45 vjet burg për Rexhep Selimin dhe 45 vjet burg për Jakup Krasniqin. 189 vjet burg. Nuk është ende një vendim gjykate, por prokuroi e hagës është çmendur, vetëm pesha simbolike e kësaj kërkesë rëndon si një verdikt paraprak jo vetëm mbi kronikën e kohës, mbi të tashmen dhe historinë, por e pëson e ardhmja.

Dhe kronika e historisë nuk është thjesht dosje juridike. Ajo është dhimbje, gjak, shpërngulje, varre pa emër, por edhe qendresë, sacrifice, ëndërr dhe ringritje, etj, etj.

Kam shkruar dikur: jo Kosova në Hagë, por Haga në Kosovë. Dhe më pas: po për gjyqin e Hagës a ka tjetër gjyq?

Sot ato më duket më aktuale se më parë.

Gjykimi i historisë apo historia e gjykimit?

Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk u krijua si krim, por si përgjigje krimi. Ajo lindi nga një terr represioni shtetëror, nga një realitet ku shqiptarët e Kosovës përjetuan përjashtimin sistematik, burgosje, dhunë dhe spastrim etnik. Në një rrethanë të tillë, qendresa mbijetesë dhe kushtim brezash, të atyre që kishin ikur dhe të atyre që do të vinin.

Të gjykojë sot drejtuesit e saj duke e shkëputur luftën nga koha e saj, nga

LIRIA KISHTE EMËR?



ai kontekst historik, është një operacion që rrezikon të prodhojë një drejtësi pa kujtesë. Dhe drejtësia pa kujtesë shpesh shndërrohet në krim tjetër, në formalizëm të një politike çnjerëzore.

Ajo po vepron për të gjykuar ekskluzivisht një strukturë të vetme të konfliktit. Pyetja që lind natyrshëm është: a mund të jetë drejtësia e plotë kur është e njëanshme?

Krimet e dokumentuara të aparatit shtetëror serb janë të njohura nga bota. Masakrat, deportimet masive, dhuna sistematike janë pjesë e arkivit të ndërgjegjes europiane. Por historia duket se po futet në një ekuilibër artificial, ku kërkohet një simetri faji edhe aty ku realiteti historik nuk e njuh atë.

Teatri absurd dhe turpi i kohës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e quajti këtë proces “një teatër absurd të turpit”, duke shtuar se historia nuk rishkruhet me pranga për ata që sollën

lirinë.” Nuk është teatër absurd, – shtoj unë, është absurdi teatral i një krimi tjetër. Ndërsa Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, deklaroi se UÇK ishte mburoja e popullit dhe se asnjë gjykatë nuk mund ta njolloste luftën çlirimtare.

Nuk janë deklarata politike, por shprehje e një ndjeshmërie të gjerë të një populli në Europë, me histori europiane, “mbrojtëse e qytetërimit europian”.

Në këtë proces në Hagë, nuk gjykohe vetëm 4 persona në krye të UÇK-së, por një epokë, një kujtesë kolektive (europiane) dhe një identitet

Rreziku i zhvendosjes morale

Kur viktimat dhe agresori vendosen në të njëjtën peshore, te ajo klasikja e Drejtësisë, historia fillon të humbasë drejtimin moral. Drejtësia nuk është thjesht përgjigje juridike; por dhe dallim mes shkakut dhe pasojës.

Nëse lufta çlirimtare reduktohet nga kjo Hagë në episod kriminal, atëherë rrezikojmë të krijojmë një narrativë ku popujt që mbrohen dënohen, ndërsa strukturat shtetërore që ushtruan dhunë shpëtojnë në mjegullën e relativizimit po nga kjo Hagë: a si kjo.

Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi duhet të ruajnë maturinë dhe unitetin. Mbrojtja e luftës çlirimtare nuk do të thotë mohimi i drejtësisë, por kërkesë për drejtësi të plotë, jo selektive.

Ç’është kjo, drejtësi ap gjykim i një anshëm politik?

E pabesueshme! Kërkesa e Prokurorit të Dhomave të Specializuara në Hagë ka shkaktuar tronditje të thellë në opinionin publik shqiptar.

Duket si rast unik në drejtësinë ndërkombëtare një gjykatë e krijuar posaçërisht për të gjykuar vetëm një palë të konfliktit, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Në asnjë tribunal tjetër nuk është ndërtuar një mekanizëm i tillë selektiv, ku agresori shtetëror, Serbia, me krimet e saj të dokumentuara, mbetet jashtë këtij gjykimi.

Drejtësia që zgjedh vetëm një palë, nuk është neutrale, por as drejtësi, guxoj të them se është vazhdim i krimeve të atyre që nuk i kanë në bankën e të akuzuarit..

Pavarësisht që e dimë se në praktikën e gjykatave ndërkombëtare, kërkesa për dënime maksimale përdoret shpesh si instrument presioni politik dhe psikologjik, jo domosdoshmërisht si reflektim i peshës reale të provave, por këtu kemi diçka më shumë, ndërtime të një narrative ku lufta çlir-

imtare trajtohet sikur të ishte projekt kriminal.

Kjo zhvendosje e fajit nga struktura shtetërore që ushtroi dhunë, te ata që i bënë ballë asaj, është e rrezikshme dhe me pasoja.

UÇK-ja, zonja Hagë, nuk ishte një ushtri që lindi në paqe. E përserisim, ajo lindi nga mohimi i të drejtave të njeriut dhe të një populli, nga dhuna shtetërore, u mbyllën shkolla, u burgosën prindër, qytetarë, u masakrua dhe po dëbohej masivisht jeta shqiptare nga trualli i vet. Të gjykojë jashtë këtij realiteti, do të thotë të kryesh jo vetëm padrejtësi juridike, por dhe të bësh falsifikim moral të historisë.

Sipas meje ka disa lexime të mundshme kjo prapaskenë në teatrin absurd të Hagës:

– Krijimin artificial të përshtypjes se “të gjitha palët janë njësoj fajtorë”.
– Lehtësim diplomatik për Serbinë dhe jo vetëm duke relativizuar përgjegjësinë e saj shtetërore.

– Një drejtësi formale, mënjanëse, që mbyll kapituj, pa i zgjidhur realisht. Çfarë duhet bërë?

– Transparencë e plotë dhe debat publik i vazhdueshëm, jo heshtje.

– Mbështetje institucionale dhe shoqërore për të akuzuarit, pa paragjykuar, por duke mbrojtur parimin e drejtësisë së barabartë.

– Kundër-narrativë historike dhe morale, e artikuluar qartë në arenën ndërkombëtare.

– Refuzim i barazimit moral mes agresorit dhe viktimës.

Drejtësia nuk është thjesht zbatim ligji, por edhe kujtesë, ndërgjegje dhe përgjegjësi historike. Kur këto mungojnë, ligji kthehet në antiprocedurë të ftohtë, në “banalizim të së keqes”. Mos duhet në Hagë duhet të postojmë “Procesin” e Franc Kafkës?

Pyes prapë: për gjyqin e Hagës a ka tjetër gjyq?



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

ARMAND SHKULLAKU

Në të njëjtën kohë që avokatja Teodoresku komentonte e vetmuar vendimin e Apelit të Posaçëm, që la përsëri në burg Erion Veliajn, kryeministri Rama njoftoi se ushtria e tij e deputetëve do të mblidhet këtë të enjte për të vendosur për Belinda Ballukun.

Nëse veprimtaria e Velisë si kryetar bashkie do të ishte e panjohur, fati i tij do t'i shëmbëllente atij të majmunit Punch, i braktisur nga nëna-parti.

Lali me Teodoreskun dhe Bela me armatën e Rilindjes në këmbë, janë fotografia më epike për të ilustruar hallin e Edi Ramës dhe organizatës që ai drejton.

Kontrasti i thellë mes braktisjes së kryetarit të Bashkisë dhe mbrojtjes deri në vetmohim të numrit dy të qeverisë, si nga partia ashtu edhe nga mediat e partisë, dëshmon për filozofinë mafioze me të cilën vepron pushteti i Rilindjes.

Nëse kapesh apo akuzohesh se ke vjedhur për vete, pra nuk e implikon direkt organizatën, fati yt vulozet në momentin që bie.

Nëse kapesh apo akuzohesh se je duke vjedhur për organizatën dhe boss-in e saj, atëherë paniku se me të kapurin bie dhe vetë organizata, e detyron këtë të fundit të rreshtohet në betejë.

Rasti i parë është Veliaj. I dyti është Belinda. Për të parin, "arsenali" i veglave të Rilindjes ishte sulmi ndaj një prokurori të vetëm. Për të dytën, po shkohet në konflikt të hapur me BE dhe SHBA që kanë shpallur mbështetjen pa kushte ndaj SPAK.

Në rastin e Velisë, teatri rilindas kundër SPAK-ut zgjati vetëm dy-tri ditë. Në aktin e parë, kryeministri u shfaq i zemëruar me prokurorët specialë, madje i kërcënoi ata me ndërhyrje ligjore pas zgjedhjeve parlamentare.

Në aktin e dytë, si zakonisht, idiotët e padobishëm të organizatës, që marrin menjëherë në gojë e tyre çdo mesazh që lëshon Rama, nxituan t'i dalin në krah kryetarit të burgosur të Bashkisë, madje të organizojnë edhe protesta në dyert e SPAK. Akt të tretë nuk pati.

VELIAJ SI MAJMUNI PUNCH, BELINDA SI HIRUSHJA E PS



Teatri ia la vendin realitetit. Kreu i organizatës mori personalisht në duar frenat e bashkisë së Tiranës.

Besnikët e lalit u eliminuan një nga një. Nën kryetaren e vendosi Rama duke detyruar Velinë të griste shkresën ku kishte guxuar të emëronte dikë tjetër. Idiotët e padobishëm rreshtën mbrojtjen ndaj ish padronit të vogël dhe, nën urdhërin publik të padronit të madh, e shkarkuan kryetarin e burgosur dhe shpallën zgjedhjet në Tiranë.

"Ka qenë fyerja më e rëndë që më është bërë ndonjëherë, sepse erdhi nga bashkëpunëtorët e mi që më njojnë më mirë se kushdo tjetër. Zot fali

se nuk dinë ç'kanë bërë", deklaroi Veliaj në kundërshtimin që i bëri shkarkimit në Kushtetuese.

Mirëpo, ata bashkëpunëtorë, të rritur e formuar me tiparin kryesor të vetë Erion Velisë, mungesën e shtyllës kurizore, nxituan të lëpjinë edhe më fort dorën e zgjatur të kryetarit të madh.

Në një hark kohor të pabesueshëm, pushteti i Erion Velisë u shkri si bora në diell. "Shokët e idealit" u bënë ministra, deputetë e drejtorë, duke qepur gojën e duke përfituar kockën e radhës. Në Partinë Socialiste, për Erion Velinë nuk flitet më. Edhe më përverse ishte mbrojtja që gjoja po i

japin Lalit të dikurshëm disa media pro qeveritare që, ndryshe nga bashkëpunëtorët politikë, duan të dëshmojnë një farë morali ndaj atij që deri dje i ka paguar me para publike si platforma të propagandës.

Perverse sepse goditjen ndaj Erion Velisë, ato e paraqitën si hakmarrje të një prokurori dhe jo si një rast që hapte debat politik e juridik.

Në rastin e Belinda Ballukut, Edi Rama është bërë mburojë e gjallë, mbi trupin e të cilit duhet të kalojë SPAK për t'i vënë asaj prangat. Kreu i organizatës po tregohet i gatshëm të ndjekë një kurs përplasje me Brukselin, vetëm për të mos lëshuar

zëvendësen e tij.

Idiotët e padobishëm që deri dje brohorisin në kor për suksesin e reformës në drejtësi dhe përbetoheshin se i hapnin rrugë çdo kërkesë të SPAK, tani thonë se janë penduar edhe për imunitetin që i hoqën Sali Berishës.

Të kapur pas belit të holluar të Belës, ata janë shndërruar në lolo që fytyrën e tyre e kanë vënë si rreckë për të mbuluar mega vjedhjet me teorinë e ndërhyrjes së drejtësisë në kompetencat e ekzekutivit.

Këtë nuk e bënë për Erion Velinë. Nuk e bëri partia, por nuk e bënë as mediat e partisë. Për Lalin u kryqëzua një prokuror i vetëm, Ols Dado, i cili për hir të së vërtetës, për atë akuzë që mori përsipër të provonte, shetoi një nga dosjet më të mira që SPAK ka prodhuar deri më sot.

Ndërsa për Belën, po të njëjtat media, nuk godasin një prokuror të caktuar por gjithë sistemin e drejtësisë.

Nuk ka më hakmarrje prokurorësh, por republikë prokurorësh. Grusht shteti, uzurpim kompetencash, përndjekje e parburgosje, drejtësi e dalë shinash e mbi të cilën duhet vënë dorë. Sepse sa kohë drejtësia nuk prek atë që është në krye, hajdutët e kapur nuk kanë rëndësi, qofshin ata edhe bashkëpunëtorët më të afërt. Por nëse ajo rrezikon pushtetin e kreut të organizatës, hajduti nuk lëshohet sepse mund të të marrë me vete.

Dhe në këtë degjenerim ligjor e moral, shkëlqejnë gjithnjë ata që deri dje të vinin duart në fyt në emër të drejtësisë së re, ndërsa tani bërtasin se drejtësia e re po i merr frymën republikës. Lali dhe Bela janë lakmuesi më i mirë i hipokrizisë dhe degradimit që ka prodhuar një pushtet kleptokrat. Njëri, i mbetur si jetim, gjoja viktimë e një prokurori.

Tjetra, me një ushtri pas vetes, gjoja viktimë e republikës së prokurorëve. Në thelb janë viktima të vetë organizatës ku kanë aderuar dhe fati i tyre shkruhet sipas hallit të Edi Ramës.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona
30 Avenons Road, London E13 8HT



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



KRYEMINISTRI SHQIPTAR DHE PRESIDENTI SERB KANË PUBLIKUAR NJË EDITORIAL TË PËRBASHKËT NË GAZETAREN E NJOHUR GJERMANE “FRANKFURTER ALLGEMEINE ZEITUNG” KU I KËRKOJNË BE ANËTARËSIM NË HAPËSIRËN SHENGEN DHE TREGUN UNIK EDHE PA U PRANUAR NË UNION.

Edi Rama dhe Aleksandër Vuçiç janë bërë sërish bashkë. Këtë herë jo për “Ballkanin e hapur” të lënë në harresë, por duke hedhur firmat në një kërkesë drejtuar Bashkimit Europian.

Edhe pse Serbia dhe Shqipëria janë vënë së fundmi në qendër të kritikave të Brukselit për hartimin e ligjeve që pengojnë drejtësinë të bëjë punën e saj, Rama dhe Vuçiç kanë publikuar një editorial të përbashkët në të përditshmen e njohur gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung”. Media gjermane duket se nuk është gjetur rastësisht pasi së fundmi Berlioni është kritikuar më i fortë për qeveritë e Tiranës dhe Beogradit.

Shkrimi i tyre mban titullin “Një rrugë realiste drejt BE-së”. Rama dhe Vuçiç shprehin se i kuptojnë shqetësimet, por sipas tyre “zgjërimi është në interesin e të gjithëve”. Ndaj ata kërkojnë nga vendet e Unionit që edhe pse nuk janë ende anëtarë të tij, të mund të bëhen pjesë e sistemit Schengen dhe Tregut Unik Europian.

“Që nga rënia e Murit të Berlinit, pothuajse asgjë nuk e ka ndryshuar Bashkimin Evropian aq shumë sa zgjerimi i tij. Duke shtrirë institucionet, rregullat dhe tregjet e saj tek anëtarët e rinj, BE-ja kontribuoi në demokraci, stabilitet dhe prosperitet në të gjithë kontinentin.

Ne i kuptojmë shqetësimet. Por zgjerimi është në interesin e të gjithëve. Ne e kemi shkruar këtë artikull së bashku, sepse pranojmë se Evropa ndjek dy objektiva po aq legjitime: vendet kandidatë kërkojnë një rrugë realiste drejt anëtarësimit të plotë; shtetet anëtare duan të ruajnë aftësinë vepruese dhe unitetin e BE-së. Këto tensione duhet të adresohen në mënyrë të hapur dhe pragmatike” – shkruajnë Rama dhe Vuçiç.

Gazetari dhe analisti gjerman Michael Martens ka zbuluar disa pjesë të shkrimit.

“Shumë evropianë pyesin nëse BE-ja mund të funksionojë në mënyrë efektive me shumë më tepër anëtarë. Shqetësimet në lidhje me vendimarrjen, ekuilibrin institucional dhe kohezionin politik janë legjitime” shkruajnë Rama dhe Vuçiç, duke shtuar: “Ne nuk jemi naivë. Këto ar-

RAMA DHE VUÇIÇ BËHEN SËRISH BASHKË FIRMOSIN LETRËN E HAPUR PËR BE-NË



gumente kanë peshë.”

Sipas gazetarit gjerman Rama dhe Vuçiç kërkojnë të anashkalojnë “kurthin e vetos” së ndonjë vendi të BE duke lejuar ato vende kandidatë që plotësojnë kushtet të hyjnë në Tregun e Përbashkët Evropian dhe Zonën Shengen, “në vend që të përpiqen për një anëtarësim të plotë politik në BE, të paktën për momentin”.

“Një qasje e tillë nuk do ta rëndonte arkitekturën e vendimarrjes së BE-së dhe nuk do të (...) ndryshonte ekuilibrin institucional të BE-së. Nuk do të përfshinte dhënien e të drejtës së vetos, komisionerë shtesë, anëtarë shtesë të Parlamentit Evropian ose ndryshime në strukturat e votimit” – argumentojnë Rama dhe Vuçiç.

“Zgjërimi i pjesëmarrjes në këto korniza (Shengeni dhe Tregu i Përbashkët) për vendet kandidatë të përgatitura mund të sjellë përfitime të prekshme për qytetarët, duke forcuar njëkohësisht pozicionin ekonomik dhe gjeopolitik të Unionit”, – thuhet në artikullin tyre.

“Ne besojmë fuqimisht se ky hap do të lehtësonte shqetësimet midis atyre shteteve anëtare që hezitojnë për zgjerimin e mëtejshëm, duke ua bërë gjithashtu shumë më të lehtë atyre që

ta paraqesin procesin në mënyrë bindëse para opinionit të tyre publik”, – shtojnë aleatët.

Gazetari gjerman Martens thotë se iniciativa e Ramës dhe Vuçiç është pjesë e një debati të vazhdueshëm, të intensifikuar jo vetëm nga politikat e Hungarisë, nëse BE-ja mund të përballojë ende pranimin e anëtarëve të plotë shtesë me të drejtë vetoje, duke pasur parasysh bllokatat e vazhdueshme nga kryeqytetet individuale.

“Për vite me radhë, jo vetëm Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka paralajmëruar se Evropa duhet të gjejë rrugë të tjera përveç anëtarësimit të plotë për të mbajtur afër Ballkanin Perëndimor (si dhe Ukrainën dhe Republikën e Moldavisë)” – shkruajnë Rama dhe Vuçiç në FAZ:

“Ne jemi bashkautorë të këtij shkrimi sepse e pranojmë që Evropa sot përballat me dy qëllime po aq legjitime. Vendet kandidatë kërkojnë një rrugë realiste drejt anëtarësimit të plotë. Shtetet anëtare kërkojnë të ruajnë efektivitetin dhe unitetin e Unionit. Ky tension nuk ka pse të jetë një dilemë me shumë zero” – shtojnë ata.

“Mundësia strategjike”, argumentojnë ata, qëndron në “integrimin e përshtetuar të vendeve kandidatë të për-

gatitura në Tregun e Vetëm dhe në Zonën Shengen”, duke shtuar se janë plotësisht të vetëdijshëm se rruga kërkon reforma të kushtueshme dhe politikisht të vështira – por qëllimi ia vlen.

Sipas Martens, ideja e tyre nuk është vetëm në interes të vendeve kandidatë, por edhe e dobishme për BE-në dhe shtetet anëtare të saj. “Zgjërimi nuk ka qenë kurrë një akt bamirësie. Ka qenë një investim i dobishëm për të dyja palët” – thonë ata.

“Unioni fiton tregje të reja, talent, thellësi strategjike dhe stabilitet politik. Anëtarët e rinj fitojnë prosperitet, siguri dhe një zë në formësimin e së ardhmes së Evropës. Dhe mbi të gjitha, paqja në kontinentin tonë vazhdon të fitojë terren në një shkallë të paparë më parë në historinë e Evropës” – shkruajnë Rama dhe Vuçiç.

Në fund Martens nënvizon se “sigurisht, aktualisht as Serbia dhe as Shqipëria (as ndonjë vend tjetër kandidat, përfshirë Malin e Zi) nuk janë gati të pranohen në tregun e vetëm dhe në Shengen. Megjithatë, artikulli i Edi Ramës dhe Aleksandar Vuçiç mund të shkaktojë një debat të rëndësishëm dhe të pritur prej kohësh.

Herën e fundit që një anëtar i ri u pranua në BE (Kroacia) ishte pothuajse 13 vjet më parë, dhe po bëhet gjithnjë e më e qartë se disa shtete anëtare të BE-së, në parim, nuk duan asnjë fuqi të re vetoje brenda BE-së, edhe nëse vendet kandidatë do të përmbushnin të gjitha kriteret e pranimit.

Ideja e ofrimit të anëtarësimit në Shengen dhe në Tregun Unik të vendeve që i plotësojnë kriteret politike dhe ekonomike (parakusht i rëndësishëm!) ka avantazhin e shmangies së kurthit të vetos.

Pra, nëse merret seriozisht nga të gjitha palët (e madhe nëse), kjo mund të fillojë një përparim dhe t’i japë fund stagnimit të zgjerimit që ka hyrë në dekadën e dytë tani. Ideja nuk lindi nga Vuçiç dhe Rama, por ata janë politikanët e parë të fuqishëm që e përqafojnë publikisht dhe qartësisht si të tyren. Edhe nëse Shqipëria dhe Serbia nuk janë vendet më të përshtatshme për ta zbatuar këtë qasje tani, një debat rreth saj mund të jetë ende i dobishëm.

Parakushti, sigurisht, do të ishte që oferta të merret seriozisht nga BE-ja dhe anëtarët e saj – më seriozisht sesa farsa e njohur aktualisht si “politika e zgjerimit të BE-së” – e mbyll Martens

ALFRED LELA

Kur bosët e gjigandëve të industrisë së makinave në Shtetet e Bashkuara u nisën për në Washington DC, në nëntor 2008, një fakt që përndryshe nuk do të përbënte lajm kombëtar, u kthye në sensacion. Shefat e Ford, General Motors dhe Chrysler udhëtuan nga Detroit në kryeqytetin federal me avionë charter për t'i kërkuar Kongresit disa miliard dollarë në paketa anti-faliment. Në çdo kohë tjetër kjo nuk do të kishte qenë më shumë se business as usual, të pasurit duke ushtruar fuqinë që kapitalizmi u jep atyre që mbërrijnë të parët në stacionin e fatit apo aftësisë.

Por, 2008-a nuk ishte vit kohësh të zakonshme. Bankat e mëdha amerikane kishin falimentuar, Wall Street ishte në gjuhë, dhe miliona amerikanë kishin humbur shtëpitë, në atë që u mbiqajti financiar bubble (fluska financiare).

Disa prej bankave u shpëtuan nga ndërhyrja e qeverisë federale sipas parimit too big to fail. Këtë fat patën edhe The Big Three, siç quheshin kompanitë legjendare të makinave me qendër në Detroit. Tri markat Chrysler, Ford dhe GM ishin pjesë e stofit kombëtar, emblema të mënyrës amerikane të jetesës.

Në kushtet e falimentit dhe krizës më të madhe ekonomike, që nga rënia e bursës në vitin 1929, kursimi dhe modestia u bënë kryefjala.

Si mundeshin, atëherë, ekzekutivët e tri kompanive të mëdha, në një kohë të shtrëngimit të rripit, në çastin kur qeveria federale, me taksat e amerikanëve, po i sh-

HELIKOPTERI I RAMËS DHE NJË EPISOD ME TRE TË MËDHENJTË E AMERIKËS



pëtonte nga falimenti, të udhëtonin drejt Shtëpisë së Bardhë me charter, konsumues të mija litrave karburant?

Pse nuk udhëtonin me linjat tregtare?!

Këto pyetje u ngritën në formë zemërimi, edhe si demonstrim i pafuqisë që shpaloste thënia too big to fail ku të vegjlit nuk përfshiheshin.

Nëse e deshcallëzon krahasimin mes Amerikës dhe Shqipërisë, duke marrë parasysh fuqinë ekonomike, popullsinë, e me radhë, mund të thuhet se i njëjti

cinizëm shpaloset edhe në vendimin e kryeministrit Rama për të marrë helikopterin dhe shkuar në Korçë.

Nëse rasti amerikan përshkruan një krizë të thellë ekonomike, rasti shqiptar përban një krizë të thellë infrastrukturore dhe qeverisjeje. Prej thujse një jave, aksi juglindor i Shqipërisë, që lidh Elbasanin me Librazhdin, Përrenjasin, Pogradecin, Korçën dhe qindra fshatrat e tyre, është i bllokuar nga disa shembje të njëpasnjëshme të brinjëve, lart dhe poshtë rrugës kombëtare.

Mijra banorë janë të izoluar nëpër fshatra, ndërkohë që mijra të tjera kanë kaluar orë të gjata në trafik. Transporti rajonal i mallrave, që qarkullojnë në Korridorin 8, është bllokuar apo pezulluar. Pamjet e zonës ku aksi ka rënë janë apokaliptike. Nëse qytetarët fajësojnë menaxhimin e kompanive dhe qeverisë për shembjet e njëpasnjëshme, Edi Rama dhe qeveritarët fajësojnë natyrën apo Zotin. Ajo që Rama nuk thotë, është se Zoti ka qenë aty, me reshjet dhe të papriturat edhe para se të vinte ai (Viti I fillon me Krishtin, jo me të). 'Kryengritja e Zotit' në mandatin e katërt të Ramës është pak e vështirë për t'u besuar, por Kryeministri njihet për pirutetat dhe nuk ka banuar asnjëherë afër fakteve dhe as së shenjtës.

Përtej kësaj, fluturimi i tij me helikopter, mbi një zonë në të cilën qytetarët e thjeshtë janë bllokuar është momenti fuck you! i Edi Ramës për popullin e tij. Në një postim, pas zhumës që u bë nga opozita dhe në rrjete sociale, Rama nuk merrej me thelbin, nuk kërkonte ndjesë, por ushtrohej, si përherë, në paralelen e vdekur të shpërfilljes dhe arrogancës, duke gjykuar kundërshtarët dhe kritikët, kur ata i gjykonin standardin.

Afërmendsh, nuk ishte ky reagimi i bosëve amerikanë në vitin e largët 2008. U shfaq pendesë, iu faturua e gjitha një nxitimi dhe

papërgjegjshmërie, pati një prapakthehu.

Jo për Edi Ramën. Ai fluturoi mbi rrugët e fundosura të qeverisjes së tij, diku mes Korridorit 8, i cili i ra në Shkumbin, dhe Via Egnatias të ndërtuar nga romakët para më shumë se 2 mijë viteve.

Çfarë paradoksi brilant i historisë. Në udhën ku dikur shkonin legjionet, karvanet e mallrave dhe ekspeditat ndëshkimore të Perandorisë Romake, sot përpëliten nënshitetasit (gati për në BE!) të Edi Ramës.

Mbi krye, për të shmangur baltën, sidomos atë të dështimeve të tij, me siguri me një ndjesi imperatoriale në lukt, helikopteron Edi Rama. Zgjat kokën për të parë poshtë në humbëtitat e provincave, ku janë ata që e votojnë dhe ata që nuk e durojnë, dhe më pas i kthehet celularit ku merr të shkruajë një tekst anatemues për ata që ankohen.

Ai nuk qeveris më. Thjesht menaxhon pozicionet e shpinës së instinktit për pushtet. Në Washington rri pas Perandorit të Romës së Re, Trumpit, me përlulësinë e një skllavi nga provinca e Ilirisë, në Iliri fluturon, pa i cekur këmba dhe, mbi kryet e nënshitetasve të cilët i ka lënë në baltë.

Me gjasë, i pëshpërit vetes: Vae victis!

cën e pashtershme. Por kur ai u shkëput nga toka mëmë, u mund menjëherë.

Për çdo udhëheqës në Kosovë, "Toka" është populli, është vota e lirë, është realiteti i dhimbshëm i qytetarit në Prishtinë, Mitrovicë apo Prizren dhe sa herë që një lider e mbështet fitoren pas lobingjeve dhe pretimeve të liderëve globalë, ai shkëputet nga kjo tokë, humbet forcën e tij natyrale dhe bëhet i prekshëm, i brishtë dhe i manipulueshëm. Forca e vërtetë e Osmanit, e Kurtit, apo e cilitdo lider tjetër shqiptar nuk mund dhe nuk duhet të qëndrojë te telefonat e liderëve globalë, por tek aftësia për të vënë dorën mbi tokën e shenjtë të Kosovës dhe për të dëgjuar rrahjet e zemrës së popullit të tyre, sepse Kosova meriton çdo sakrificë për qëndrueshmëri politike që nuk vjen si dhuratë, por si meritë e proceseve demokratike.

Në këtë betejë mes dritës së sovranitetit dhe hijeve të autokracisë së sponsorizuar, duhet të jemi të qartë se demokracia është një proces që kërkon integritet çdo ditë dhe se kur liderët zgjedhin rrugën e shkurtër të lobimit, ata në fakt zgjedhin rrugën e gjatë të rrënimit të shtetit.

1 President nderi i Institutit për Politika Publike dhe Mirëqeverisjes.
2 James Freeman Clarke (1810–1888) ishte një teolog, shkrimtar dhe reformator social amerikan.

ARBEN MALAJ

"Politikani mendon për zgjedhjet e ardhshme, ndërsa burri i shtetit mendon për gjeneratën e ardhshme"

James Freeman Clarke

Debati për rizgjedhjen e Presidentes Osmani, të cilën e respektoj për diplomacinë e saj aktive po konturohet si "udhë kryqi", ku do të dallojmë Presidenten Osmani si shtetarja atd-hedashëse nga politikania e zakonshme. Winston Churchill, një nga arkitektët e lirisë botërore, na lajmëronte se "Çmimi i madhësisë është përgjegjësia", ndërsa Abraham Lincoln, na la një mësim të pavdekshëm: "Pothuajse çdo njeri mund t'i përballojë fatkeqësitë, por nëse dëshiron të testosh vërtet karakterin e një njeriu, jepi atij pushtet". Në këtë dritë, nëse Presidentja Osmani zgjedh të kërkojë avantazhe të mbështetja e jashtme, ajo jo vetëm dëmton legjitimitetin e saj të brendshëm, por rrezikon të shpërbëjë fuqinë e integritetit që ka ndërtuar deri më sot. Mesazhi Presidentit Trump në Bordin e Paqes se, "Nëse i ke punët keq për mandatin e dytë, më telefono mua" — ishte sa joshës në dukje, aq edhe i rrezikshëm në esencë. Media prestigjioze ndërkombëtare i konsiderojnë këto ndërhyrje si një armë gjeostrategjike e mirëfilltë që përdoret kundër arkitekturës demokratike evropiane. Kjo mospërrputhje gjeopolitike mes qasjes izolacioniste dhe asaj të bashkëpunimit SHBABE

MES LEGJITIMITETIT TË VOTËS DHE "MBËSHTETJEVE TELEFONIKE"

për imponim lidërshipi, nuk duhet në asnjë mënyrë të materializohet si një ndërhyrje kirurgjikale në Kosovë. Shihen me shqetësim reagimet e unifikuar të vendeve evropiane, të cilat, pavarësisht nëse u përkasin të majtëve apo të djathtëve, janë shprehur publikisht dhe prerë kundër Bannon, Musk, Grenell, zv.Presidentit dhe vetë Presidentit amerikan, të cilët kanë lobuar hapur për të rrëzuar liderë legjitimë evropianë dhe për të instaluar figura që u binden agjendave të tyre personale.

Kur një lider si Vjosa Osmani pranon apo flirtin me këtë lloj "garancie" të jashtme, ajo po mbjell farën e një deficiti demokratik të rrezikshëm, ku kostoja ekonomike ashtu siç paralajmëron FMN-ja kur thotë se krizat politike dhe mungesa e qëndrueshmërisë institucionale kanë dëmtonur rëndë cilësinë dhe ritmet e rritjes sonë ekonomike, duke e kthyer Kosovën në një vend që prodhon më shumë politikë në vend që të prodhojë me shume mirëqenie reale dhe të qëndrueshme.

Analiza e kostove dhe përfitimeve nga modeli i liderëve të sponsorizuar

nga jashtë tregon një bilanc shqetësues dhe kërcënues për demokracinë funksionale. Përfitimi është individual/personal dhe afatshkurtër. Ndërsa disavantazhet janë kolektive dhe afatgjata, duke filluar nga cenimi i rëndë i integritetit moral të liderit, deri te rreziku real i rrëshqitjes drejt një autoritarizmi të ri, ku pushteti nuk buron nga vota e lirë e votuesve, por nga telefonatat ndërhyrëse dhe imponuesve ndaj votuesve, që duhet të jetë vetëm i lirë.

Ky model rrit varësinë ndaj lobimit të jashtëm, ku paratë e taksapaguesve apo resurset kombëtare shpesh përdoren për të blerë mbështetje në qendrat e fuqisë globale.

Vjosa Osmani duhet të jetë jashtëzakonisht e kujdesshme lidhur me trashëgiminë që po ndërton, sepse historia nuk i mban mend liderët për numrin e telefonatave që kanë marrë, por për gjurmën që kanë lënë në forcimin e institucioneve të pavarura, dhe nëse ajo lejon që mandati i saj të kthehet në një "dhuratë" gjeopolitike, ajo do të mbahet mend si liderja që shkëmbeu sovranitetin e popullit të

saj me një mbijetesë personale.

Legjitimiteti i vërtetë, jo thjesht për postin e Presidentit, por për çdo ambicie të saj të ardhshme, duhet të vijë vetëm nga qytetarët e Kosovës dhe nga ajo harmoni apo kompromis antikrizë mes partive politike që tregon pjekuri shtetërore, sepse çdo politikë që nënvlerëson apo anashkallon votën e brendshme, në fakt po ushqen "përbindëshat e brendshëm" që fshihen në psikën e çdo udhëheqësi: egon e shfrenuar që të thotë se je i pazëvendësueshëm, etjen për pushtet që nuk njeht limite morale dhe frikën paralizuese nga humbja e mandatit që të shtyn drejt kompromiseve të turpshme.

Kur një udhëheqës fillon t'i ushqejë këta përbindëshat, ai e humb aftësinë për të parë interesin kombëtar dhe i errësohet gjykimi, duke u bërë pre e pretimeve të liderëve globalë që sot të japin dorën e nesër të kthejnë shpinën sipas interesave të tyre pragmatike.

Këtu vjen në ndihmë figura mitologjike e Anteut, gjigantit që ishte i pamposhtur për sa kohë prekte Tokën, nënën e tij Gea, nga e cila merrte for-



DITMIR BUSHATI

Për dekada të tëra Konferenca e Sigurisë e Mynihut ka shërbyer si një takim vjetor i aleancës transatlantike. Një vend ku udhëheqësit, diplomatët, profesionistët e gjeopolitikës amerikane dhe europiane mbledhen së bashku për të shkëmbyer mendime rreth sigurisë ndërkombëtare. Pikënisja e saj, që prej vitit 1963, mbështetet mbi supozimin thelbësor se marrëdhëniet midis SHBA-ve dhe Europës janë të qëndrueshme me një ndarje të qartë detyrash, nën udhëheqjen e SHBA-ve si garantuese të sigurisë. Pas rënies së Murit të Berlinit, Konferenca e Sigurisë e Mynihut u transformua edhe si një vend dialogu për politikëbërësit dhe opinionbërësit transatlantikë me ato të fuqive dhe kontinenteve të tjera. Për shembull, fjalimi i Presidentit rus, Vladimir Putin, në vitin 2007, në Mynih, shënoi një pikë kthese të politikës dhe pozicionimit të Rusisë, në periudhën që pasoi rënien e Murit të Berlinit, nga një partnere në një sfiduese të rregullave dhe vlerave të rendit botëror dhe Perëndimit.

Sa herë kam marrë pjesë në këtë konferencë, kam vënë re se temat kryesore të diskutimit lidheshin me raportet midis Perëndimit dhe Rusisë, Kinës, fuqive të mesme apo Jugut Global. Mirëpo vjet atmosfera ndryshoi. Zëvendës-presidenti amerikan, JD Vance, në fjalimin e tij nuk nguroi të identifikonte partnerët europianë si “problemin kryesor” të dobësisë së Perëndimit. Raporti i konferencës i këtij viti, i titulluar “Nën

THYERJA E BESIMIT

Shkatërrim”, ku SHBA-të përshkruhen si prishës të rendit botëror të ndërtuar në breza, dhe pa ide të qarta për rendin zëvendësues, nuk reflektonte një partneritet transatlantik, por një mosbesim në rritje.

Për shkak të klimës të tensionuar brenda aleancës transatlantike, këtë vit vëmendja u përqendrua te raportet brenda vetë Perëndimit, duke eklipsuar raportet këtij të fundit me fuqitë e tjera. Krahasuar me fjalimin e vjetshëm të Zëvendës-presidentit JD Vance, fjalimi i Sekretarit të Shtetit Marco Rubio ishte më i ngrohtë, duke synuar të qetësonte aleatët europianë. Edhe pse Rubio argumentoi se fati i SHBA-ve do të jetë gjithmonë i ndërlidhur me atë të Europës, ai e bëri të qartë se bashkëpunimi do të varej nga shtetërimi i kufijve, lufta kundër emigracionit dhe rritja e shpenzimeve të mbrojtjes.

Në fjalim ra në sy mospërmendja e agresionit rus në Ukrainë dhe mungesa e referencave tek vlerat demokratike dhe besimi i përbashkët në liri që dikur motivonin aleancën e NATO-s. Në vend të kësaj, Rubio paraqiti një vizion të bazuar në “qytetërimin perëndimor”, i cili do të luftonte kundër armiqve të vërtetë: migracionit, kultit të klimës dhe formave të tjera të degjenerimit modern. Thelbi i mesazhit të Sekretarit të Shtetit ishte i qartë: SHBA-të do të vazhdojnë partneritetin me Europën, jo domosdoshmërisht bazuar mbi vlerat e përbashkëta, por sipas intereseve të Uashingtonit. Ky është vizioni në të cilin SHBA-të synojnë të zëvendësojnë Perëndimin e Luftës së Ftohtë, i cili është përshkruar si “bota e lirë”, me Perëndimin kulturor me rrënjë në krishterim. Gjatë dy dekadave të fundit, mënyra se si SHBA-të e kanë përcaktuar interesin e tyre kombëtar në kontekstin e rendit gjeopolitik ka ndryshuar gradualisht.

Presidenti Trump është një përshpejtues i këtij procesi, por jo shkak. Dhe ky proces do të vazhdojë edhe kur ai të mos jetë më në Shtëpinë e Bardhë. Kjo përfshin një numër fushash politike që kanë qenë thelbësore për orientimin e politikës së jashtme amerikane pas Luftës së Ftohtë: një zhvendosje nga tregtia e lirë drejt politikës industriale, subvencioneve dhe tarifave më të larta; një angazhim i reduktuar ndaj sigurisë kolektive në mungesë të një ndarjeje dukshme më të madhe të barrës nga aleatët europianë në NATO mbi kostot e mbrojtjes; kundërshtim ndaj politikës së dobët të sigurisë kufitare dhe emigracionit dhe skepticizëm ndaj promovimit të demokracisë, ndihmës së huaj dhe arkitekturës ndërkombëtare të organizatave shumëpalëshe.

Secili prej këtyre ndryshimeve pasqyron ankesa të hershme nga ana e qytetarëve amerikanë në të gjithë spektrin politik dhe ka rezultuar në një ndryshim gradual, por tani strukturor në politikën e jashtme të SHBA-ve në nivel botëror. Nëse do ta krahasoja rendin botëror dhe frymën që karakterizon marrëdhëniet transatlantike me një kompjuter, do të thosha se tani jemi në fazën e rindezjes së tij, por në ekran nuk janë shfaqur ende programet me të cilat mund të punojmë. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dy elementë kryesorë kanë orientuar marrëdhëniet ndërkombëtare. Njëri është sistemi ndërkombëtar, apo siç njihet ndryshe grupi i organizatave shumëpalëshe të përqendruara rreth OKB-së. Tjetri është fuqia e SHBA-ve. Deri në rënien e Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik bota ishte bipolare. Më pas, SHBA-të ishin superfuqia e vetme në botë. Ndonëse OKB-ja ishte ende e rëndësishme, fuqia amerikane peshonte po aq rëndë në ngjarjet botërore. Dështimin e rendit të vjetër në shumë aspekte nuk e

mohojnë dot as mbështetësit më të zjarrtë të OKB-së.

Çështje të rëndësishme si lufta dhe ndryshimet klimatike ngecin në diskutime, rezoluta dhe votime, pa u adresuar kurrë. Mospërfaqësimi i balancuar i të gjitha kontinenteve dhe vetoja që gëzojnë pesë shtete në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, i bën vendimet e pamundura. Vështruar në këtë kontekst, SHBA-të po shtyjnë përpara një ide të ndryshme, duke i dhënë përparësi një rendi tjetër që vendos theksin tek aleancat ndërshtetërore dhe shtetet si aktorë kryesorë dhe jo tek organizatat shumëpalëshe. Sipas këtij vizioni, bashkëpunimi efektiv ndiqet më së miri përmes koalicioneve të vullnetit, jo përmes kornizave që shpërndajnë autoritetin nëpër organizata shumëpalëshe me interesa të ndryshme. Veprimi kolektiv funksionon kur shtetet pjesëmarrëse bien dakord për mjetet dhe qëllimet.

Nga ana tjetër, europianët po vetëdijësohen me këtë realitet të ri brenda aleancës transatlantike, ku kemi një zhvendosje nga vlerat tek interesat e përbashkëta. Uniteti europian përkundër qëndrimit të administratës ‘Trump’ në rastin e Groenlandës, ofrtë në planin e sigurisë apo në planin ekonomik, duke njoftuar tarifa të ndërsjella me ato të njoftuara nga amerikanët, është shembulli më i qartë i kësaj vetëdijeje.

Në këto kushte, pyetja që lind natyrisht është nëse mund të rivendoset besimi i thyer në marrëdhëniet transatlantike. Kjo është ende e mundshme duke u nisur nga një pikënisje e re, që përqendrohet kryesisht tek interesat e përbashkëta të aleatëve nga të dyja anët e oqeanit. Është fakt i pamohueshëm se Strategjia e Sigurisë Kombëtare e SHBA-ve që u botua nëntorin e kaluar e vendos të tretën si prioritet raportin me Europën, pas Hemisferës Perëndimore dhe Indo-Paqësorit. Një zhvendosje, e cila ka nisur gjatë administratës së parë të Presidentit Obama.

Është fakt i pakundërshtueshëm se për shkak të presionit të ushtruar me këmbëngulje nga administrata e Presidentit Trump, europianët tashmë po kontribuojnë shumë më tepër ushtarakisht brenda aleancës. Dhe për më tepër po mbajnë barrën kryesore të luftës në Ukrainë. Rëndësia e Europës në botë do të varet nga gatishmëria e saj për të jetuar në këtë realitet të ri transatlantik. Ndërsa vendosmëria dhe veprimi i përbashkët europian ka të ngjarë të vazhdojnë, pjesa më e madhe e energjisë do t'i kushtohet punës brenda kornizave ekzistuese transatlantike, veçanërisht NATO-s. Fakti që Mbretëria e Bashkuar dhe Italia po marrin komandat e NATO-s nga SHBA-ja sinjalizon një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një “shtylle” europiane brenda aleancës.

Ndoshta në fund të këtij procesi, NATO-ja do të duket ndryshe, përfshirë edhe raportet e forcave dhe kontributeve mes aleatëve, ku roli i SHBA-ve do të jetë i pazëvendësueshëm, sidomos në lidhje me mbrojtjen bërthamore, shërbimet inteligjente dhe inteligjencën artificiale. Një shtyllë europiane brenda NATO-s është rruga më efektive drejt një Europe të sigurt, ndërsa SHBA-të po zvogëlojnë përgjegjësinë për mbrojtjen e kontinentit. Sigurisht që kjo është më e arritshme sesa shndërrimi i BE-së në një aleancë ushtarake apo edhe mbrojtja e Europës përmes koalicioneve të formalizuara të atyre që janë të gatshëm dhe të aftë. Por perspektiva më afatgjatë mund të jetë vetëm ajo ku vendet europiane janë të destinuara të afrohen me shumë në fushat që kanë të bëjnë me pozicionin e tyre gjeopolitik, që lidhen me sigurinë gjeografike dhe aftësinë e tyre për të pasur mbrojtjen, sigurinë dhe qëndrueshmërinë. Rruga për të arritur në këtë pikë do të jetë e rrëmujshme. Mirëpo, ky realitet i ri transatlantik mund të shërbejë edhe si nxitje drejt një Europe të re. Shënim:

*Analiza është botim i Fondacionit “Friedrich Ebert”

Dotech
website

AKËMA NUK KENI NJË WEBSITE?

BUSINESS CARDS

BANNERS

POSTERS



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT



Dotech
website

KRIJO WEBSITIN TËND

MOS RRI ANONIM

Me mijera klientë mund të jenë të intersuar për biznesin tuaj, por mbase nuk e dijnë që ti ekziston...



Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT

Dotech
websites

☎ 020 7018 7929

☎ 078 5997 7545

☎ 073 4066 5946

VETON SURROI

Rrjedha historike nuk ndalet, ngase duket e paarsyeshme: ilustrim nga Rusia që sulmoi Ukrainën dhe nga Serbia që kur ra Muri i Berlinit u përcaktua në anën e gabuar të historisë 1.

Një natë para se të fillonte lufta në Ukrainë, në një darkë në Vjenë e pyeta një ish-diplomate evropiane, të përfshirë më herët në negociatat e formatit Normandi për ndërprerjen e luftës kur Rusia filloi sulmin e parë më 2012, se a do të hynte Rusia në luftë frontale në Ukrainë mëngjesin e ardhshëm? Me tërë përvojën e saj dhe mesazhet që i vinin pandërprerë në telefon e pas një pauze të gjatë shpërëritiu dhe tha që nuk di. “Sinqerisht nuk e kam idenë”.

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën.

Gazetaria profesionale është interes publik. Mbështetja juaj ndihmon që ajo të mbetet e pavarur dhe e besueshme. Kontribuoni edhe ju. 1 euro e bën dallimin.

Letër lexuesit — pse po kërkojmë mbështetjen tuaj

Në një formë të çuditshme pakkush në Evropën kontinentale do të mund të pajtohej me parashikimin se Rusia do të hynte në luftë frontale. Sipas një shkrimi të gjatë hulumtues të “The Guardian”, të botuar këtë javë, ishin vetëm udhëheqësit e SHBA-së dhe Britanisë së Madhe me shërbimet e tyre inteligjente, që dinin deri në hollësi jo vetëm se lufta frontale pushtuese do të fillonte në filan date, por edhe se çfarë ishte në hollësi plani ushtarak i sulmit.

Ajo darkë dhe ato ditë para pushtimit ishin metaforë e mjaftueshme e një rendi e kulturë politike që mbështetej në arsyen e shëndoshë. Arsyeja njerëzore e cilidto evropiani të rëndomtë do të tregonte se është e pakuptueshme që një shtet evropian të përpiqet ta pushtojë tjetrin dhe për këtë të rrezikojë njerëz, para dhe pozicioni ndërkombëtar. Dhe, meqë është e pakuptueshme dhe shkon kundër arsyes, cilidto evropian, nga qytetari i rëndomtë deri tek ai që është në pushtet, i dukej se Rusia nuk do të hynte frontalisht me ushtri në Ukrainë.

ADVERTISING

Mësimi i parë i 24 shkurtit të para katër vjetëve ishte se kemi hyrë në një ndryshim historik, ku thuhet konvencioni i deriatëhershëm i arsyes; pra po, Rusia hyn me tanke në Ukrainë për të thyer njëkohësisht rendin e sigurisë që është ndërtuar në kontinentin evropian nga fundi i Luftës së Dytë Botërore.

2.

Atë ditë duhej të flisja në konferencë - me lojën e fatit, kushtuar normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë - dhe i kondensova argumentet në dy pika që mendoj se janë valide edhe sot. Një, që lufta pushtuese ruse në Ukrainë ishte kthesë historike e dimensionit të krahasueshëm me rënien e Murit të Berlinit. Dhe dy, që kjo lëvizje e madhe tektonike do të ketë ndikim të madh gjithandej Evropës, rrjedhimisht edhe në procesin e normalizimit. Kur ra Muri i Berlinit, Kosova u përcaktua për frymën historike perëndimore të demokracisë, lirisë dhe vetëvendosjes, ndërsa Serbia për vazhdimin e monizmit politik, luftën kundër popujve të tjerë dhe Serbinë e madhe.

Dhe, këtu po vazhdojmë me mësimet e para katër vjetëve.

Mësimi i dytë, atëherë, është se lufta frontale e Rusisë kundër Ukrainës sado të duket veprim i paarsyeshëm, jo vetëm që është rrënim i një rendi (të ngjashëm me peshën historike si rënia e Murit të Berlinit), por gjatë këtyre katër vjetëve është edhe ndërtim i konturave të rendit të ri ndërkombë-

tar. Ato kontura për kontinentin evropian duket një fjali që shkon disi kështu: lufta në Ukrainë është punë e Evropës dhe SHBA-ja do ta përkrahë këtë luftë e me të edhe sigurinë e Evropës me një partneritet (që nënkupton garanci bërthamore, ndihmë në inteligjencë, etj.), por jo si palë në luftë konvencionale; rrjedhimisht kontinenti evropian (me Britaninë e Madhe dhe Turqinë të përfshira në të) merr përgjegjësinë për siguri të vetes, mobilizon shpenzimet për mbrojtje dhe ballafaqohet me nevojën për një vendimarrje më efektive kolektive. Sepse, siç u pa me mësimin e parë, kemi hyrë në periudhë ku gjërat vetëm pse janë kundër arsyes nuk ndalen së ndodhuri.

3.

Mësimi i tretë është ai i ndikimit që kanë ndryshimet e këtyre tektonike në marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Kur ra Muri i Berlinit, Serbia zgjodhi anën e gabuar historike - ishte kundër demokracisë, lirisë së popujve të ish-Jugosllavisë e në fund edhe paqes që po krijohet në një Evropë të çliruar nga komunizmi. Prej atëherë deri më sot, në një formë a tjetër, e

posaçërisht gjatë shekullit XXI kufiri mes Kosovës dhe Serbisë në një masë të madhe ka qenë kufiri ndarës mes botës euroatlantike dhe interesave gjeopolitike ruse.

Ky rrezik nuk është tejkaluar dhe mund të ripërtërihet në rikonfigurimin botëror. Serbia nuk duhet të bëjë gjë të re, vetëm të vazhdojë me përcaktimin e deritanishëm, prej mohimit të parimit të barazisë së palëve në marrëveshjet e lehtësuara nga BE-ja (që nga mosnënshkrimi, rezervimet gojore e me shkrim) e deri të mbështetja apo organizimi i sulmeve paraushtarake kundër Kosovës si në Banjskë.

Dhe, këtu për BE-në (dhe në vitet e kaluara SHBA-ja) vlen mësimi i parë: vetëm pse veprimet e Serbisë duken të paarsyeshme, nuk është se nuk do të ndodhin. Pra, fakti se SHBA-ja dhe BE-ja janë përpjekur ta tërheqin Serbinë me një perspektivë transformimi çfarë kanë përjetuar të gjitha shtetet ish-komuniste në BE e NATO, nuk do të thotë se Serbia nuk do ta lidhë ardhmërinë e vet me Rusinë, gjë që shkon kundër arsyes. Apo se do të vendosë që të rrijë në politikën e “katër karrigeve” (shpikje e ish-presidentit Tadiq): me SHBA-në, BE-në,

Rusinë e Kinën. Serbia e tanishme do të largohet nga Rusia vetëm kur të ndiejë se është e detyruar ta bëjë.

4.

Kështu mbërrijmë te mësimi i katërt: kontinenti evropian është zgjuar me ndenjen e pasigurisë për veten. Pra, katër vjet më pas, nuk po zhvillohet një luftë diku atje në Lindje, ku dikur fërkohej Perandoria austro-hungareze me atë ruse; është në pyetje i tërë sistemi i sigurisë, jetës, demokracisë së popujve evropianë. Përzgjedhja është e thjeshtë, mes një hapësire të sigurisë apo pasigurisë evropiane. Ajo që deri dje konsiderohej e garantuar nga rendi botëror, tash kërkon përgjegjësi evropiane dhe ribalancim përgjegjësish me SHBA-në.

Ajo hapësirë kërkon që të mos ketë vija ndarëse brenda kontinentit evropian si mes Kosovës dhe Serbisë. E kjo do të thotë se i tërë Ballkani Perëndimor duhet të jetë pjesë e hapësirës evropiane të sigurisë; një politikë parësore që duhet të ngrihet tej varësisë nga teket e ndonjërit prej shteteve të Ballkanit Perëndimor e të humburit të rugës historike. koha



MBËRRITJA PAS SHUMË PERIPECIVE E ALEKSANDËR MOISIUT NË BUENOS AIRES, INTERVISTA ME GJENIUN E SKENËS BASHKËKOHORE BOTËRORE

AURENC BEBJA

“Diario Crítica” ka botuar, të dielën e 7 prillit 1929, intervistën ekskluzive asokohe me Aleksandër Moisiun në Buenos Aires, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Moisiu, tragjiku i madh gjerman, sapo ka mbërritur në Buenos Aires dhe tregon përshtypjet e udhëtimit të tij.

Një udhëtim me probleme. — “Të kryesh tetë funksione. Kam gjashtëdhjetë ditë lundrim. Angazhimet e mëparshme do ta pengojnë tragjedianin e shquar të ofrojë më shumë se tetë shfaqje.

Moisiu ndodhet në Buenos Aires që nga mbrëmë. Pasagjeri nga Cap Arcona zbarkoi sapo u hoqën kufizimet sanitare për anijen transatlantike, i cili megjithatë, po shkurtonte edhe më tej itinerarin e tij, që është shumë i shkurtër në Buenos Aires për shkak të kontratave të tij në pritje.

Aleksandër Moisiu është i ndjeshëm, do të kalojë si yll në qiellin tonë artistik. Moisiu, siç e kemi thënë tashmë, është një nga figurat kryesore të skenës bashkëkohore botërore.


Parisi, Londra dhe Nju Jorku kanë përshëndetur të gjithë figurën tragjike që ka bërë që turmat të dridhen nga emocionet. Francezët, të cilët ishin aq të kursyer në lëvdatat e tyre për të huajin, ishin ata që treguan entuziazmin më të madh në kritikate e tyre, ku disa e shpallën atë gjeni, e të tjerë aktorin më të madh dramatik të gjallë.

Pasi e nisi karrierën e tij në teatër si një ekstra, karriera e tij evropiane dhe triumfi i tij i fundit në Nju Jork kulmojnë me famën e tij aktuale. Gjermano-gjermani tragjik, me gjak hebre, bir i një shqiptari dhe nënë italiane, i lindur në Trieste nën dominimin austriak ? — por gjerman, për shkak të kulturës së tij intelektuale dhe gjuhës me të cilën shpreh temperamentin e tij artistik, ai do të na japë vetëm katër shfaqje të talentit të tij: “Fantazmat”, “Hamleti”, “Dymbëdhjetë mijë” të Bruno Franck-ut dhe “Kufoma e gjallë” e Tolstoit. E pamë mbrëmë duke folur familjarisht në të gjitha gjuhët, duke pritur me ankth kohën e debutimit të tij para një publiku të ri dhe të largët.

Për çdo zotëri, çdo nder. Moisiu është një nga zotërit e artit dramatik. Mos hezitoni të na dërgoni mirëseardhjen tonë të ngrohtë dhe të shprehim kënaqësinë tonë për të ndarë me ju aktivitetet tona teatrale në Buenos Aires.

Moisiu, poliglot

Figura e Aleksandër Moisiut, e konsideruar artistikisht, është mjaft e njohur që ne të përpiqemi ta zbulojmë atë; Fizikisht ai është një njeri me tërheqje të veçantë; Me gjatësi mesa-



tare, i hollë, me një fytyrë të rrumbullakët, të bardhë, me flokë të valëzuar, ngjyrë bronzi, një grimasë ironike në gojë dhe me sy depërtues, këto janë linjat e përgjithshme të këtij lloji që mbushin skenën dramatike në teatrot e mëdha evropiane dhe të Amerikës së Veriut.

Moisiu është një poliglot dhe me fraza në italisht, gjermanisht dhe frëngjisht na tregon odisenë e udhëtimit të tij :

— Për të luajtur tetë ditë në Buenos Aires — do të më duhet të lundroj për gjashtëdhjetë ditë ...

Ndërsa isha në Nju Jork, i dhashë fjalën Urban-it që të vija me të në Buenos Aires. Ideja për t’u njohur me këtë pjesë të planetit të vogël që ne jetojmë më tërhoqi dhe nëse mbaj fjalën e nderit do të më duhet të lundroj për gjashtëdhjetë ditë dhe do të duhet të pres deri në maj për të pranuar kontratën e mrekullueshme që më ofroi një kompani e madhe filmash për të luajtur në dy filma shumë të rëndësishëm, “Kean” të Dumas dhe “Dishepulli i Djallit” të Bernard Show.

Moisiu, aktor filmi (kinemaje)

Këta filma, bazuar në këto vepra të mrekullueshme, do të realizohen duke përdorur një proces modern që po revolucionarizon artin kinematografik sot, ai quhet film që flet (film me zë), dhe siç duket edhe emri i tij, aktori

shihet në të njëjtën kohë kur dëgjohej.

Një udhëtim me probleme

Udhëtimi im ishte vërtet plot ngjarje : për të takuar Urbanin dhe për t’u kthyer në Kaliforni më 15 maj, më duhej të hipja në anijen e parë që nisej për në Evropë në Nju Jork në një ditë kur shpërtheu një stuhi e jashtëzakonshme që nuk na la gjatë gjithë udhëtimit tonë për në Hamburg.

Meqenëse moti i keq na bëri të vonoheshim për rreth 70 orë, nuk munda të shihja familjen time me mbërritjen time në Gjermani dhe nga anija që po më çonte atje shkova drejtpërdrejt në Cap Polonio, në bord patëm një udhëtim shumë të lumtur, por siç thotë thënia e vjetër spanjolle :

“Epo, hajde keq, nëse vjen vetëm”, dhe ja, në brigjet e Brazilit mësuam se do t’i nënshtroheshin një karantine shëndetësore, dhe si pasojë e një vonese të re dhe shtyrjes së pashmangshme të debutimit tim.

Kompania Urban

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, shton Moisiu, kompania Urban që udhëton në bordin e Weser-it do të duhet të durojë një karantinë më serioze se e imja, gjë që ka bërë të nevojshme shtyrjen e sezonit përsëri.

Pas performancës sime në Buenos Aires, do të kaloj Andet për të hipur



në një anije në Valparaíso dhe do të arrij në San Francisco, Kaliforni, më 15 maj, sipas fjalës time.

Moisiu do të performojë në Odeón të merkurën me datë 10 prill në shfaqjen “Espectros — Fantazmat”.

1932/ “Nuk e di nëse teatri gjerman do të mbijetojë nën presionin e censurës...”, intervista me Aleksandër Moisiu në Kopenhagë

Gazeta norvegjeze “Dagbladet” ka botuar, të premten e 2 shtatorit 1932, intervistën asokohe me Aleksandër Moisiun në Kopenhagë, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Moisiu i frikësohet censurës së teatrit gjerman.

Udhëtimi në Itali me “Faustin” për dimër.

Aleksandër Moisiu, i cili pas pak ditësh do të vijë në Oslo, ku do të jetë i ftuar me shfaqjen “Fausti” në Teatrin Kombëtar, aktualisht po qëndron në Kopenhagë, ku është intervistuar. Kanë kaluar 10 vjet që kur aktori i madh ka vizituar për herë të fundit kryeqytetin danez dhe i pyetur se pse ka kaluar kaq shumë kohë që nga vizita e tij për herë të fundit, ai përgjigjet :

— Vështirë se mund të më akuzoni se jam besdisës. Dhjetë vjet më parë pata një sukses të madh në Kopenhagë, por që atëherë nuk e kam shfaqur veten këtu. Arsyeja nuk është se më është kërkuar të qëndroj larg! Tani, kur krijohet një stil Faust-fiorestillinig, edhe me dy artistë si Bassermann-i dhe Karin Evans, nuk ka gjasa që të më refuzojnë.

— Meqë ra fjala, pse nuk keni qenë këtu për kaq shumë kohë ?

— Nuk e kam zakon të përfitoj nga sukseset. Bota është mjaftueshëm e madhe. Do të doja t’i thosha përshën-

detje një qyteti si Kopenhagen dhe pastaj të zhdukem përsëri. Ushqimi i ringrohur nuk ka shije të mirë : një aktor duhet të punojë vazhdimisht dhe vetëm kur të ketë arritur pikën e zhvillimit të tij, që mund të tregojë diçka të re, duhet të kthehet prapa.

— A është pakënaqësia me teatrin gjerman që ju shtyn të shkoni në turne ?

— E organizova këtë turne sepse ishte viti i përvjetorit të Gëtes. Mendova se do të ishte kënaqësi të krijoja një turne që nuk kishte vetëm një yll, por përbëhej nga disa aktorë të shquar. Kjo është arsyeja pse unë solla Bassermann-in dhe Karin Evans-in, dhe ne kemi luajtur me sukses të jashtëzakonshëm në Holandë, Belgjikë, Francë dhe Zvicër.

Ju na bëni një pyetje në lidhje me teatrin gjerman. Ne vetë nuk dimë shumë për të. Ne gjithashtu nuk e dimë nëse teatri do të mbijetojë në kohët e ardhshme nën presionin e censurës.

Unë vetë nuk jam më me Reinhardtin. Kam udhëtuar shumë, duke përfshirë edhe Amerikën, ku kam luajtur në një film të Warner Brothers, një variant i “Keans”, i quajtur “The King’s Lodge”. Më pëlqeu shumë, por nuk kam regjistruar më. Në sezonin e ardhshëm do të luaj në Itali në italisht – siç mund ta dini, jam italian nga lindja. Në një ansambël italian kam ndërmend të performoj me “Faustin” në të gjithë Italinë. Verën e ardhshme kam ndërmend të luaj “Loja e vjetër e të gjithëve” në Sienë, edhe në italisht.

— Ndihehi më shumë si italian sesa gjerman ?

— Unë jam aq kozmopolit në zemrën time sa nuk jam përpjekur kurrë të zbuloj nëse kam ndjerë këtë apo atë. Unë përpiqem të jem një qenie njerëzore më shumë se një kombësi. Në fund të fundit, kombësia është vetëm çështje dokumentesh identiteti.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



The Albanian

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona

ADRESA E ZYRAVE:

30 AVENONS ROAD LONDON E13 8HT

Dotech
websites 

 **020 7018 7929**

 **078 5997 7545**

 **073 4066 5946**

**190 Merton High Street
Wimbledon
London SW19 1AX**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Ne mund t'ju ndihmojmë

- **Asylum & Immigration**
- **New Point Based System**
- **Settlement Applications (ILR)**
- **European Law**
- **Nationality & Travel Document**
- **Human Rights Applications**
- **High/Court of Appeals**
- **Over Stayers**
- **Work Premits**
- **Visa Extensions**
- **Judicial Reviews**
- **Tribunal Appeals**



Konsultimet falas



07774222062



07878335000

TEL: 0208 5401 666

TEL: 0208 672 0666

